



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 131

Tiranë – E martë, 23 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 601, datë 1.6.2026	Për delegim kompetence..... 12053
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 627, datë 10.6.2026	Për delegimin/autorizimin e kompetencave të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për nënshkrimin e dokumentacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, te zëvendësministri..... 12053
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 639, datë 15.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë..... 12054
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 640, datë 15.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 12054
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 641, datë 15.6.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 628, datë 11.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë” 12057
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 644, datë 16.6.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 399, datë 14.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës”..... 12057
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 645, datë 16.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 12058

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 21.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 388, datë 5.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 162 (87-2024-219), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2041 (307), datë 12.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	12059
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 28.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 65, datë 3.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 73, datë 6.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-20 (1), datë 14.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	12084
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 3, datë 25.5.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.....	12094



URDHËR

Nr. 601, datë 1.6.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit, z. Fatmir Guri.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- Kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;

- Çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje te njëjta, 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrit, sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 627, datë 10.6.2026

**PËR DELEGIMIN/AUTORIZIMIN E
KOMPETENCAVE TË MINISTRIT TË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL,
PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË
KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”,
TE ZËVENDËSMINISTRI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 1, të vendimit nr. 519, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës dhe përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”; të nenit 28 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për nënshkrimin e korrespondencës dalëse me institucione të ndryshme, kur ato përfshijnë informacion të klasifikuar në nivelin “Sekret”, te zëvendësministri, z. Fatmir Guri.

2. Ngarkimin e z. Guri me ndjekjen dhe me zbatimin e këtij urdhri, në përputhje me legjislacionin në fuqi, lidhur me informacionin e klasifikuar.

3. Ngarkimin e Sektorit të Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për ndjekjen dhe njoftimin e urdhrit strukturave përkatëse, që përpunojnë informacionin e klasifikuar në nivelet e sipërcituara.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 639, datë 15.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SUEDISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Suedisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Helsingborg*	-	-

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 640, datë 15.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e



Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të

Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28



deri në 15.1.30, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqname në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë

që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 632, datë 12.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 641, datë 15.6.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRI
NR. 628, DATË 11.6.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të

nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 628, datë 11.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 644, datë 16.6.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRI
NR. 399, DATË 14.4.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E DANIMARKËS”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3 të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 399, datë 14.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës”.



2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 645, datë 16.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;
- d) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;
- e) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*
3.	Castilla y León	Valladolid	Valladolid*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës, të cilat nuk kanë pasur njohim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.



7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 68, datë 21.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 51, datë 21.4.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 21.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (Sh) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shoqëria “Restur” sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me autorizim përfaqësimi.

Shoqëria “Mediterranean Investment Group” sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me autorizim.

Redi Molla, përfaqësuar nga avokatët Ermir Beta dhe Ardian Visha, me prokurë të posaçme.

Ollga Molla, përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

Shoqëria “5D Konstruktion” sh.p.k., përfaqësuar nga avokatët Arjan Salati dhe Henrik Ligori, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 388, datë 5.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 162 (87-2024-219), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2041 (307), datë 12.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31, shkronja “b”, 33, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, shoqërisë “Restur” sh.p.k. (*shoqëria “Restur”*), shoqërisë “Mediterranean Investment Group” sh.p.k. (*shoqëria “Mediterranean Investment Group”*), Redi Mollës dhe Ollga Mollës, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “5D Konstruktion” sh.p.k. (*shoqëria “5D”*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka bashkuar dy procedime penale në një të vetme me nr. 75 të vitit 2023, për veprat penale “Shkelja e barazisë së



pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP), në ngarkim të disa personave, ndaj të cilëve janë vendosur edhe masa të sigurimit personal, përfshirë kërkuesin Redi Molla. Në datën 4.6.2024, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 287/2 dhe 25 të KP-së, duke shënuar, ndër të tjerë, edhe emrin e subjektit të interesuar, shoqërisë “5D”, si të dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë hetimeve paraprake janë ngritur dyshime se kërkuesi Redi Molla dhe shtetasi M. Q., të cilët kanë ushtruar funksione drejtuese në një ndërmarrje publike në varësi të Bashkisë së Tiranës, janë pronarët *de facto* të subjektit të interesuar, shoqërisë “5D”, të regjistruar në regjistrin tregtar më 22.1.2016, që nga momenti i themelimit të saj e në vazhdim. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kjo shoqëri është shpallur fituese në disa procedura prokurimi të hapura nga kjo ndërmarrje publike, si autoriteti kontraktor, duke u favorizuar padrejtësisht në garë, ndërkohë që kërkuesi Redi Molla ishte edhe titullari i këtij autoriteti kontraktor. Hetimet janë shtrirë në 7 procedura prokurimi të zhvilluara nga ndërmarrja publike në fjalë, si autoritet kontraktor, dhe në 5 procedura të tjera të shpallura nga Bashkia e Tiranës, si dhe institucionet e tjera në varësi. Hetimet janë shtrirë edhe në drejtëm të deklarimeve të pasurisë dhe të interesave të kërkuesit Redi Molla, duke u ngritur dyshimet se ai ka fshehur faktin që ka në zotërim të tërthortë subjektin e interesuar, shoqërinë “5D”. Sipas Prokurorisë së Posaçme, prindërit e kërkuesit Redi Molla, i ndjeri S. M. (i ati) dhe kërkuesja Ollga Molla (e ëma), kanë fituar pronësinë mbi dy pasuri të paluajtshme, duke u ngritur dyshimet se financimi i tyre është siguruar pjesërisht nga subjekti i interesuar, shoqëria “5D”. Nga të dhënat e regjistrit tregtar, ka rezultuar se kërkuesi Redi Molla është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “Restur”, përfituar me trashëgimi nga i ati i tij, i cili deri në vitin 2023 ka depozituar në total 566.440 euro në llogarinë e shoqërisë. Kjo shoqëri zotëron edhe një kuotë të barabartë me 24% të kapitalit të shoqërisë “Mediterranean Investment Group”. Për këtë të fundit ka realizuar punime ndërtimi subjekti

i interesuar, shoqëria “5D”, për të cilat është paguar pjesërisht.

3. Në kuadër të këtij procedimi penal, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për disa pasuri, përfshirë: i. *pasurinë e paluajtshme nr. 5/523*, zona kadastrale nr. 8150, e llojit truall, e ndodhur në Tiranë, e regjistruar në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla (kërkueses Ollga Molla dhe të ndjerit S. M.), si pasuri e përfituar pjesërisht me burime financimi nga shoqëria “5D”, burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale; ii. *pasurinë e paluajtshme nr. 5/648*, zona kadastrale nr. 8150, e llojit truall, e ndodhur në Tiranë, e regjistruar në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla (kërkueses Ollga Molla dhe të ndjerit S.M.), si pasuri e përfituar pjesërisht me burime financimi nga shoqëria “5D”, burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale; iii. kërkuesen, *shoqërinë “Restur”*, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe *kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”*, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, si pasuri që përbën vlerën ekuivalente të asaj që është përfituar nga veprat penale, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e produktit të veprës penale; iv. subjektin e interesuar, shoqërinë “5D”, përfshirë kuotat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në pronësi të kësaj shoqërie.

4. Me vendimin nr. 388, datë 5.7.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, si të bazuar në ligj dhe në prova, duke vendosur masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasuritë e kërkuara, pasi ka çmuar se në rastin konkret plotësoheshin njëkohësisht kushtet ligjore të përcaktuara nga neni 274, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe neni 36, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “ç”, dhe pikat 2 e 3 të KP-së. Për administrimin e pasurive të sekuestruara është ngarkuar Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

5. Në drejtëm të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në ligj për vendosjen e masës së sekuestros preventive, ajo gjykatë ka analizuar fillimisht për ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të*



bazuar në prova. Në vlerësimin e asaj gjykate, rezulton i mbështetur dyshimi se kërkuesi Redi Molla së bashku me shtetasin M. Q. kanë në zotërim faktik subjektin e interesuar, shoqërinë “5D” dhe, si të tillë, kanë rol thelbësor në administrimin dhe në mënyrën e funksionimit të saj, si dhe kanë kontroll e bartin interesa të drejtpërdrejtë në veprimtarinë ekonomike, duke përfituar drejtpërdrejt vlera financiare nga shpërndarja e fitimeve. Gjatë kohës që kërkuesi Redi Molla ka ushtruar detyrën e drejtorit të ndërmarrjes shtetërore, për pasojë edhe të titullarit të autoritetit kontraktor, shoqëria “5D” ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në 7 procedura prokurimi në sajë të favorizimit dhe të shkelleve ligjore të kryera nga anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave dhe të miratuara nga Redi Molla. Këto procedura prokurimi janë kryer në shkelle të ligjit, duke krijuar pabarazi dhe njëherësh favorizim të kundërligjshëm, po kështu janë zhvilluar edhe në konflikti interesi për shkak të prezencës së interesave pasurorë mbi shoqërinë pjesëmarrëse në procedurën konkurruese. Në këtë pikë, ajo gjykatë ka evidentuar se duhet të jetë pjesë e hetimit në vijim edhe përcaktimi i saktë dhe i plotë i vlerave të mundshme që përbëjnë përfitimet e kërkuara/marra prej Redi Mollës (*shih paragrafin 85, faqja 81, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Ky konkluzion, sipas saj, mbështetet edhe nga mandatpagesa e datës 9.7.2020, për pagesën e dy kësteve për blerjen e pasurive të paluajtshme në emër të prindërve të Redi Mollës. Lidhja e kërkuetit, Redi Mollës, me shoqërinë “5D” përforcohet edhe nga të dhënat që rezultojnë mbi investimin në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, në të cilën ka cilësinë e ortakut shoqëria “Restur”, zotëruese e 24% të kapitalit, me ortak dhe administrator të atin e kërkuetit Redi Molla, që më pas ka ndërruar jetë. Ky i fundit ka transferuar në rrugë bankare në kapitalin e shoqërisë “Restur” shumën 564.000 euro, që më pas është transferuar nga shoqëria “Restur” tek shoqëria “Mediterranean Investment Group”. Pra, sipas gjykatës, shoqëria “Restur” nuk rezulton të ketë zhvilluar ndonjë veprimtari tregtare të vetën, pasi e gjithë vlera e investuar prej saj në shoqërinë “Mediterranean Investment Group” e ka burimin në kreditimet e ish-ortakut. Për më tepër, shoqëria “Mediterranean Investment Group” ka kontraktuar shoqërinë “5D” për ndërtimin e një objekti, ndërsa nga komunikimet ka rezultuar se kërkuesi Redi Molla ka drejtuar

punimet (*shih paragrafët 83–87, faqet 72–82, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

6. Lidhur me kushtin e *lidhjes së mjaftueshme me veprën penale*, për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuetit Redi Molla, të dyshuara si të fituara pjesërisht me burime financimi nga shoqëria “5D”, që rrjedhin nga produkte të veprës penale, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274, pika 1 i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja “b”, i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Ajo gjykatë ka arritur në këtë përfundim, pasi ka vlerësuar se nga hetimet ka rezultuar: i. dy këste të blerjes së këtyre pasurive janë paguar nga shoqëria “5D” (administruar mandatpagesa për këstin e dytë në vlerën 100.000 euro, me objekt “*pagesë kësti 2 për blerje, pasuritë nr. 5/523 dhe nr. 5/648*”); ii. të dhëna të mjaftueshme për të konkluduar se shoqëria “5D” kontrollohet plotësisht nga kërkuesi Redi Molla, i cili mbart interesa të fshehur në këtë shoqëri, ka dyshime të arsyeshme se këto dy pasuri, jo vetëm janë blerë pjesërisht me vlera monetare nga shoqëria “5D”, por edhe se përbëjnë pasuri të fshehura të tij. Në këtë konkluzion gjykata ka arritur pasi: i. të paktën dy këste në vlera të konsiderueshme janë paguar nga shoqëria tek e cila mbart interesa të drejtpërdrejtë pasurorë kërkuesi Redi Molla; ii. ai njihet nga qiramarrësit e pasurive si pronar i tyre; iii. ato janë rikonstruktuar, duke u investuar vlera të konsiderueshme, po nga shoqëria “5D”, e lidhur dhe në të cilën mbart interesa kërkuesi Redi Molla. Si përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se për këto dy pasuri ka të dhëna të mjaftueshme se përbëjnë produkte të veprave penale, objekt procedimi. Edhe pse neni 36, pika 2, i KP-së parashikon se nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale, në rastin konkret, sipas saj, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre, pasi i përket organit të akuzës që në vijim të hetimeve, të qartësojë nëse e gjithë vlera e tyre vjen si pasojë e transformimit të produktit të tyre të dyshuar të veprës penale, ose vetëm një pjesë e saj, duke u saktësuar kjo vlerë. Lidhur me faktin se këto pasuri të paluajtshme janë në pronësi të prindërve të kërkuetit Redi Molla, sipas asaj gjykate nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre, pasi ka lidhje të mjaftueshme mes tyre dhe veprave penale objekt procedimi (*shih faqet 88 dhe 89, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).



7. Po në drejtim të *lidhjes së mjaftueshme me veprën penale*, për shoqërinë “Restur”, përfshirë pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë “Mediterranean Investment Group”, ajo gjykatë ka vlerësuar se ka vend që ky subjekt, me të gjithë pasuritë e tij, të sekuestrohen si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale për të cilat procedohet kërkuesi Redi Molla, për aq sa mund të përcaktohet në këtë fazë të procedimit. Sipas asaj gjykate, në kushtet kur rezulton se shoqëria “Restur” dhe çdo pasuri e saj është në pronësi të kërkuesit Redi Molla, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre si sende/të drejta që përmbushin vlerën ekuivalente të produktit të veprës penale, në kuptim të nenit 274, pika 2 të KPP-së dhe nenit 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së, duke lënë si detyrë që në vijim të hetimeve të saktësohet edhe vlera e produktit në raport me vlerën e sendit/asetit të sekuestruar për të përmbushur vlerën ekuivalente të tij (*shih paragrafin 97.6, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

8. Lidhur me ekzistencën e *rrezikut se disponimi i lirë i sendit ose i objektit që lidhet me veprën penale, mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, në rastin konkret, rreziku për tjetërsimin, me pasojë rëndimin e mëtejshëm të pasojave të veprës penale, është prezent, real dhe i afërt, për sa kohë tjetërsimi i pasurive të paluajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, kalimi i të drejtave mbi kontratat e porosisë për pasuri të paluajtshme apo tjetërsimi i pronësisë së kuotave, ose i aseteve të shoqërive tregtare, është një veprimtari e cila zhvillohet normalisht dhe në mënyrë dinamike, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre. Për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla, ajo gjykatë ka arsyetuar se ato pasuri, duke qenë se deri në atë fazë të hetimit rezultojnë të jenë produkte të prejardhura të veprës penale, në kuptim të nenit 36, pika 2, të KP-së, përbëjnë një rrezik real dhe prezent për transferimin e tyre tek të tretët, me qëllim shmangien e konfiskimit. Ky transferim mund të ndodhë në çdo kohë, duke qenë se janë të regjistruara në emër të të tretëve dhe jo personave nën hetim, duke rënduar kështu pasojat e veprës penale. Në të njëjtën masë gjykata ka vlerësuar edhe rrezikun për tjetërsimin e të drejtave pasurore të kërkuesit Redi Molla mbi kuotat dhe asetet e shoqërisë “Restur” dhe kuotën

që kjo e fundit zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”. Pavarësisht masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg” të vendosur për kërkuesin Redi Molla, sipas gjykatës, tjetërsimi rrezikon të realizohet përmes përfaqësimit.

9. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit, duke pretenduar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë në shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe se mungojnë shkaqet ligjore për vendosjen e kësaj mase, e cila është joproporcionale. Sipas tyre, nuk është paraqitur asnjë lidhje e qartë dhe e paekuivoke midis sendeve/shoqërive të vendosura nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet, shoqëritë tregtare kanë një historik të gjatë aktiviteti të ligjshëm dhe nga një verifikim i thjeshtë i burimeve të tyre financiare mund të vërtetohet bindshëm ligjshmëria e tyre; kërkuesja Ollga Molla nuk është person nën hetim; masa e sekuestros është joproporcionale për sa kohë që kërkuesit disponojnë burime të ligjshme që justifikon çdo investim ose transaksion të kryer. Duke qenë se kërkuesit nuk kanë pasur akses në fashikullin gjyqësor, kanë rezervuar të drejtën për të paraqitur argumente shtesë në seancën gjyqësore.

10. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 162 (87-2024-2019), datë 31.7.2024, ka miratuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, të parashikuar nga neni 274 i KPP-së, por më një arsyetim të ndryshëm ligjor, pasi nuk është pajtuar me kualifikimin juridik të fakteve penale. Sipas saj, ekziston dyshimi i arsyeshëm se personat e proceduar kanë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat akuzohen në kuadër të grupit të strukturuar kriminal si formë e posaçme bashkëpunimi dhe se lënia pa masë siguri pasurore e çdo gjurme të pasurisë kriminale të subjektit të interesuar, shoqërisë “5D”, përbën një mundësi praktike dhe reale të bashkëpunëtorëve për të fshehur origjinën e tyre, duke lehtësuar sakaq vijimësinë e pashqetësuar të grupit të strukturuar kriminal dhe kryerjen e veprave të tjera kriminale. Në lidhje me formën e shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se ajo duhet shqyrtuar në dhomën e



këshillimit me praninë e palëve, ndërsa ka vërejtur se në rastin konkret është shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe vetëm me praninë e prokurorit, megjithatë ka çmuar se kjo nuk ka prodhuar pasoja ligjore që ta bënin vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë të cenueshëm.

11. Shkaqet e ankimit të kërkuarve ajo gjykatë i ka gjetur haptazi të pabazuara, pasi ka vlerësuar se nga të dhënat e deritanishme të procedimit penal provohet se pasuritë e sekuestruara e kanë origjinën nga fondet e shoqërisë “5D”. Për rrjedhojë, sipas saj, nuk ka asnjë dobi vërtetimi i aftësisë paguese apo pasurive të kërkuarve Redi dhe Ollga Molla për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale krijuara të ndër vite nga shoqëria “5D”. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se masa e kërkuar nga Prokuroria e Posaçme pajtohet plotësisht me parimin e proporcionalitetit dhe se, për më tepër, konstatohet që ka një përputhshmëri dhe gjurmueshmëri ideale ndërmjet produkteve të veprës penale dhe tjetërsimit të saj tek të tretët, ose përvetësimit dhe investimit të saj nga bashkëpunëtorët e proceduar apo të paproceduar deri më tani nga kjo prokurori.

12. GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar edhe disa çështje kryesisht, duke i lënë si detyra për vijimin e hetimeve paraprake. Ndër të tjera, ajo gjykatë ka shprehur mospajtim me Prokurorinë e Posaçme lidhur me kufirin e vendosur për vlerën e pasurive, me qëllim që ajo të mos e kalojë vlerën e ekspertuar të fitimeve kriminale të realizuara nga shoqëria “5D”. Sipas saj, mënyra e zbatimit të nenit 274 të KPP-së është e pabazuar në nenin 36 të KP-së, sipas së cilës pasuritë e kërkuara për sekuestrim nuk duhet të tejkalojnë vlerën ekuivalente të fitimeve kriminale që rrjedhin nga 13 procedurat e realizuara të prokurimit.

13. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs, ndër të tjerë, kërkuar, duke pretenduar zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë e vendimeve gjyqësore të lidhura kryesisht me vendimmarrjen në mungesë të kontradiktoritetit, paanshmërinë e gjyqtarit të gjykatës së apelit dhe daljen jashtë shkaqeve të ankimit, me pasojë rëndimin e pozitës së kërkuarve, si dhe mungesën e kushteve ligjore për caktimin e masës. Kërkuar kanë pretenduar se atyre nuk u është dhënë akses gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe se gjykimi në apel është zhvilluar në dhomën e

këshillimit, pa praninë e palëve, ku kërkuarve u është lënë një afat kohor shumë i shkurtër për të paraqitur ankim, që e ka bërë objektivisht të pamundur paraqitjen e një akti ekspertimi kontabël. Sipas tyre, në fashikullin gjyqësor mungon një analizë e mirëfilltë financiare për burimet e ligjshme të pasurive, arsye për të cilën kanë paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një analizë financiare për të ardhurat e prindërve të kërkuar Redi Molla (kërkuar Ollga Molla dhe të ndjerit S. M.), të hartuar nga një audituese ligjore e pavarur (akti i ekspertimit i datës 11.9.2024).

14. Me vendimin nr. 00-2024-2041 (307), datë 12.12.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Për pretendimin e kërkuarve lidhur me mosnjohimin për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe më tej, për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në gjykatën e apelit, pa praninë e palëve, ajo gjykatë, në mungesë të një parashikimi konkret në dispozitat që normojnë sekuestron preventive, ka referuar në dispozitat për masat e sigurimit personal, duke vlerësuar se edhe masat e sigurimit pasuror, si rregull, shqyrtohen në dhomën e këshillimit, me kushtin që të zbatohen rregullat për këtë rit gjykimi dhe të njoftohen paraprakisht palët sipas nenit 426 të KPP-së, në mënyrë që të kenë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim. Pavarësisht këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka asnjë pengesë që të procedojë me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore sa herë që lind nevoja e dëgjimit të palëve ose verifikimit të pjesës faktike të çështjes. Në çështjen konkrete, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk konstatohet pavlefshmëria e vendimeve gjyqësore, pasi GJKKO-ja e Apelit ka shqyrtuar ankimin e kërkuarve, duke i njoftuar paraprakisht për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në gjykatën e apelit, si dhe duke i dhënë mundësinë për të paraqitur edhe parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në gjykatën e apelit. Për këtë arsye, por edhe për shkak se dispozitat që normojnë sekuestron preventive nuk parashikojnë domosdoshmërinë e thirrjes së palëve, Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar asnjë pavlefshmëri me pasojë cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 27–31, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për sa i përket mënyrës së procedimit të GJKKO-së Shkallës së Parë, ajo gjykatë ka mbështetur



arsyetimin e GJKKO-së së Apelit (*shih paragrafin 33, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

15. Pretendimin për mungesën e kushteve për caktimin e masës së sekuestros preventive, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar, duke arsyetuar, *së pari*, se, në mënyrën sesi janë parashtruar pretendimet, vlerësohen të karakterit faktual, pra jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë dhe, *së dyti*, kushtet dhe kriteret për caktimin e masës janë analizuar në mënyrë të detajuar e mbi bazën e të dhënave të hetimeve paraprake nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cenueshme. Lidhur me pretendimet se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri e një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Për sa u përket pretendimeve për arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ndonëse në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Ndërsa lidhur me pretendimin se GJKKO-ja e Apelit ka rënduar pozitën e kërkuësve, duke shtuar si nevojë sigurimi rrethanën e kryerjes së veprës në bashkëpunim të posaçëm, të papretenduar nga Prokuroria e Posaçme dhe të paevidentuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Lartë, ndonëse ka vlerësuar se formalisht qëndron, ka çmuar se ai argument nuk përbën shkak për të cenuar atë vendimmarrje për shkak të mosardhjes së pasojave ligjore (*shih paragrafin 41, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Pretendimin se masa është shpërpjesëtimore, Gjykata e Lartë e ka çmuar të pabazuar, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk evidentojnë që masat e caktuara ndaj

pasurive të jenë dukshëm arbitrare ose joproporcionale (*shih paragrafin 42, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Së fundmi, ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për paanshmëri të gjyqtarit të apelit, për shkak të mungesës së shkaqeve të arsyeshme të mbështetura në prova, pasi ka çmuar se, në thelb, arsyet mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes së gjyqtarit konform tagrave që i njëj ligji (*shih paragrafin 43, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Në datën 27.6.2025, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 24.9.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

18. Në datën 20.4.2026, një anëtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, pasi paanshmëria mund të vihet në dyshim për shkaqe të tjera. Po në të njëjtën datë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara u kanë cenuar:

19.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

19.1.1 *E drejta e aksesit* e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi gjykatat e posaçme e kanë zhvilluar gjykimin vetëm në prani të prokurorit dhe, për rrjedhojë, janë mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga ai. Veçanërisht, kërkuësit kanë përgatitur një akt ekspertimi kontabël, që është një provë thelbësore e këtij procesi, mirëpo nuk kishin arritur ta paraqisnin atë apo kundërshtimet e tyre për shkak se nuk ishin të pranishëm, si dhe për shkak të afateve të shkurtra në dispozicion për kundërshtimin e tyre. Dispozitat procedurale që rregullojnë sekuestron preventive nuk parashikojnë ndonjë mënyrë të veçantë gjykimi, siç parashikohet në rastin e caktimit të masave të sigurimit personal, në të cilin ligji parashikon shprehimisht se vendimi merret në dhomën e këshillimit. Ndërsa në rastin



konkret, ligjvënësi ka konfirmuar vullnetin e tij për gjykimin e këtyre kërkesave në mënyrën tradicionale të zhvillimit të seancës gjyqësore. Në shkelje të normave procedurale, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa njoftuar, pa thirrur dhe pa dëgjuar kërkuessit, edhe pse në përfundim të gjykimit janë cenuar të drejtat e tyre të pronësisë. GJKKO-ja e Apelit jo vetëm që ka legjitimuar shkeljen procedurale të lejuar në gjykatën e shkallës së parë, por e ka thelluar atë nëpërmjet mohimit edhe nga ana e saj të parimit të kontradiktoritetit, duke zhvilluar një gjykim tërësisht formal. Edhe Gjykata e Lartë, megjithëse kishte mundësi të riparonte shkeljet procedurale të gjykatave të posaçme, vendosi të linte në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke u mohuar përfundimisht kërkuessve mundësinë të paraqisnin prova në mbrojtje të tyre, përfshirë aktin e ekspertimit për pasuritë e prindërve të kërkuessit Redi Molla.

19.1.2 *Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe paanësisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka shtuar si elemente mbështetëse për nevojat e sigurimit, kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, duke rikualifikuar faktin penal sipas neneve 143, 287, 334 të KP-së, ndërkohë që prokurori në kërkesën për caktimin e masës është mjaftuar me bashkëpunimin e thjeshtë. Ajo gjykatë ka tejkaluar rolin e saj si gjykatë e hetimeve paraprake, duke e konfunduar me rolin e gjykatës së seancës paraprake. Po e njëjta gjykatë ka mbajtur dhe herë të tjera këtë qëndrim, konkretisht në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuessin Redi Molla, por në atë rast kjo parregullsi është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim. Përsëritja e të njëjtit qëndrim është indikacion i qartë se GJKKO-ja e Apelit e ka shqyrtuar çështjen me bindjen se kërkuessi Redi Molla është fajtor dhe se veprat e kryera nga ai janë më të rënda se ato të pretenduara nga Prokuroria e Posaçme, duke rënduar pozitën e tij. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi ose sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit apo kualifikimin e faktit penal, pasi, siç ajo arsyeton, udhëhiqet nga një bindje e plotë se ai është fajtor dhe tenton ta orientojë Prokurorinë e Posaçme që të veprojë sipas bindjes së saj.

19.1.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi në çështjen konkrete gjykatat nuk kanë paraqitur një

lidhje të qartë midis pasurive dhe aseteve të vendosura nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet kërkuessi Redi Molla. Ato nuk kanë specifikuar se në cilën prej kategorive të nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së përfshihen sendet e sekuestruara. Duke pasur parasysh faktin se disa nga pasuritë e sekuestruara janë në pronësi të personave të tretë, që nuk kanë lidhje me procedimin penal (kërkuessa Olga Molla), organi i akuzës dhe gjykatat duhet të kishin arsyetuar me argumente konkrete arsyet e vendosjes së sekuestror për këto pasuri. Shoqëritë tregtare dhe i ndjeri S. M. kanë një historik të gjatë aktiviteti tregtar dhe do të mjaftonte një verifikim i thjeshtë i burimeve financiare për të vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Ky është tregues që gjykatat kanë kryer një gjykim formal, pa një arsyetim ligjor mbi baza shkencore kontabël. Si organi i akuzës, ashtu edhe gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme mbi kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit pasuror. Ato nuk kanë arsyetuar se përse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë ishte mjeti i vetëm për të siguruar qëllimin e synuar dhe nuk kishte asnjë mjet tjetër, në kuptim të parimit të proporcionalitetit që të arrinte një rezultat më pak të dëmshëm në të drejtën kushtetuese. Çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim dhe, sidomos atyre që nuk janë nën hetim, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja duhet të urdhërohet si mjet i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë.

19.1.4 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi në procesin që lidhet me vazhdimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuessit Redi Molla, Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprave penale, ka vendosur të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë. Përballë po së njëjtës sjellje të GJKKO-së së Apelit, mbi po të njëjtat fakte, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim katërcipërisht të kundërt kësaj radhe, duke krijuar rrjedhimisht konfuzion që cenon rëndë parimin e sigurisë juridike.



19.2 Të drejtën për pronë private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi:

19.2.1 Ndërhyrja *nuk është e bazuar në ligj*, sepse legjislacioni penal material dhe procedural lejon kufizimet e kësaj të drejte vetëm ndaj personave që dyshohet se kanë kryer veprën penale, ndërsa në rastin konkret masa është shtrirë automatikisht dhe vetëm për shkak të lidhjes familjare, edhe te pjesët takuese të kërkuases Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim, në mungesë të plotë të të dhënave ose të një analize nga gjykatat. Ajo ka qenë bashkëpronare në pasuritë objekt sekuestroje përpara se t'i trashëgonte i biri. Nuk rezulton që gjykatat të kenë arsyetuar se përse përfshihet dhe pjesa takuese e saj në sekuestro dhe cilat janë faktet që pasjellin lindjen e dyshimit se pjesa e saj takuese mund të jetë krijuar nga të ardhurat nga ndonjë veprë penale.

19.2.2 Ndërhyrja *nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë*, pasi ajo nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së, sipas të cilit duhet të provohet lidhja e sendit për të cilin kërkohet të vendoset masa e sigurimit pasuror me veprën penale në ngarkim të kërkuarit. Nga akti i ekspertimit të kryer nga organi i akuzës, duket qartë se fokusi i tij ka qenë shoqëria “5D” dhe jo verifikimi i të ardhurave të kërkuarit Redi Molla ose familjarëve të tij, për të cilat nuk ka asnjë indicie ose provë për të arritur në konkluzionin që pasuritë e paluajtshme janë produkte të veprës penale.

19.2.2.1 Lidhur me *pasurinë e paluajtshme nr. 5/523*, të trashëguar nga S. M. tek kërkuari Redi Molla, nuk rezulton që të jetë hetuar ose arsyetuar për lidhjen e saj me veprat penale për të cilat akuzohet ky kërkuar. Paga e pretenduar prej 100.000 eurosh e kryer nga shoqëria “5D” është bërë vetëm për pasurinë nr. 5/648, ndaj është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë nr. 5/523. Nuk ka asnjë arsyetim për sekuestrimin e pjesës takuese të kërkuases Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim.

19.2.2.2 Lidhur me kërkuaren, shoqërinë “Restur”, fituar nga trashëgimia, nuk është hetuar dhe as arsyetuar se ku është dyshimi që kjo pasuri mund të jetë krijuar nga produktet e veprës penale. Në këtë kuptim, është e paqartë sesi kuota që kërkuari Redi Molla ka në këtë shoqëri, me vlerë nominale 100 lekë, mund të dyshohet si produkt i veprës penale. Shoqëria ka histori të gjatë aktiviteti tregtar, që nuk është verifikuar.

19.2.2.3 Lidhur me kërkuaren “Mediterranean Investment Group”, rezulton se ajo është krijuar më 1.9.2020, me kapital 100 lekë, aq sa e ka edhe sot. Nga krijimi i saj e deri në vitin 2023, nga ana e të ndjerit S. M. është kaluar në shoqëri vlera 564.000 euro në kuadër të zhvillimit të projektit, e cila nuk ishte verifikuar për burimin e saj, që të përligjte vënien e sekuestros për të.

19.2.3 *Nuk plotësohet kriteri i proporcionalitetit*, pasi kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuarve është bërë përmes një mjeti të papërshtatshëm, siç është sekuestroja preventive, në kushtet kur qëllimi i kërkuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihet me mënyra të tjera, si ndalimi i tjetërsimit të pasurive dhe i kuotave të sekuestruara duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe në regjistrin tregtar, për më tepër, në kushtet kur vlera prej 564.000 eurosh do të shërbente për të paguar kontraktorët dhe nënkontraktorët. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pse prevalon interesi publik mbi të drejtat e pronësisë dhe as pse vendosja e sekuestros është masa me e përshtatshme. Po kështu, vendosja e kërkuarit Redi Molla nën masën e sigurimit personal, pasjell edhe kufizime të të drejtave të tij të pronësisë, pasi ai është i kufizuar nga disponimi i tyre, si pasojë e kufizimit të lirisë.

20. **Subjekti i interesuar, shoqëria “5D”**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet e gjykatave për vendosjen dhe miratimin e sekuestros preventive *en block*, mbi të gjitha pasuritë e shoqërisë “5D”, nuk kanë respektuar kriterin e proporcionalitetit, në mënyrë që kufizimi i së drejtës së pronësisë të bëhej me mjete sa më të përshtatshme, të mjaftueshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm që duhet të ndjekë juridiksioni. Ato gjykata qëllimisht e kanë përzier veprimtarinë sipërmarrëse të financuar me fonde publike të shoqërisë “5D” me veprimtarinë e saj private, e cila nuk ka asnjë lidhje me tenderët e pretenduar të fituar në mënyrë të padrejtë nga kjo shoqëri. Shoqëria “5D” ka marrë disa kredi me vlera të konsiderueshme, të cilat janë fonde tërësisht të ligjshme, ndaj sekuestroja është shpërpjesëtimore në raport me qëllimin e ligjshëm që pretendon të realizojë. Për më tepër, kjo masë shpërpjesëtimore po rrezikon të krijojë pasoja duke dëmtuar edhe interesat e individëve privatë, klientë të shoqërisë, të cilët kanë parapaguar në mënyrë të ligjshme nëpërmjet sistemit bankar kështet e pagesave për blerjen e apartamenteve që kanë porositur në



pallatin që kjo shoqëri po ndërton në rrugën “Siri Kodra”, Tiranë.

21. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi:

21.1.1 Kërkuesve u është garantuar e drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve e të kontradiktoritetit. Ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ndryshe nga rregullat procedurale të shqyrtimit të masave të sigurimit personal, në rastin e masave të sigurimit pasuror nuk ka rregullime të detajuara mbi ritin e gjykimit të tyre, si për gjykimin fillestar, ashtu edhe për atë rishikues në gjykatën e apelit. Kjo do të thotë se gjykimi në shkallë të parë i kërkesës së prokurorisë bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, me kusht që palët të njoftohen dhe të kenë mundësi për të paraqitur parashtrime 5 ditë përpara seancës, duke iu garantuar mundësia që të paraqesin argumentet e tyre dhe në këtë mënyrë të “dëgjohen”. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit i ka njoftuar paraprakisht palët për shqyrtimin e ankimit, duke iu dhënë mundësinë për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në gjykatën e apelit. Për sa i takon gjykatës së shkallës së parë, me të vërtetë ka pasur një shkelje lidhur me ritin e gjykimit, porse, ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ajo nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi në thelb nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore. Kërkuesit kanë pasur mundësi të njihen me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, të ushtrojnë mjetet e ankimit dhe të paraqesin argumentet e tyre përpara gjykatës më të lartë. Shqyrtimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme është në përputhje me ligjin, standardet kushtetuese dhe konventore, si dhe ka ruajtur balancën ndërmjet interesit publik dhe të drejtave individuale.

21.1.2 Kërkuesve nuk u është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë* dhe ai i *paanshmërisë* nga GJKKO-ja e Apelit, për sa kohë që arsyetimi tej qëndrimit të Prokurorisë së Posaçme, tej arsyetimit të vendimit të shkallës së parë dhe tej shkaqeve të ankimit, nuk shoqërohen me asnjë pasojë ligjore, duke qenë se arsyetimi për këtë pikë nuk ka forcë detyruese, por vetëm orientuese ndaj Prokurorisë së Posaçme në këtë fazë të procedimit penal (hetime paraprake), ndaj nuk përbën shkelje të tillë sa ta bëjë nul vendimin e marrë. Pavarësisht se Prokuroria e

Posaçme nuk ndan të njëjtin qëndrim me gjykatat e posaçme në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal ose llojit të bashkëpunimit, të dyja gjykatat kanë të njëjtin qëndrim dhe kanë argumentuar mjaftueshëm ekzistencën e kushteve të parashikuara në nenin 274 të KPP-së. Gjykatat kanë përmbushur detyrimin e tyre për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave dhe ato nuk kanë zhvendosur barrën e provës të kërkuesit dhe as nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Ato kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarve, duke argumentuar praninë e një sërë indiciesh që lidhin sendin/pasurinë me fakte që kualifikohen si vepra penale.

21.1.3 Shkaqet e parashtruara nga kërkuesit për të argumentuar cenimin e *parimit të sigurisë juridike* lidhen me vendimin nr. 18, datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit (për vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit Redi Molla), i cili nuk është objekt i kërkesës. Gjithashtu, ai vendim është prishur nga Gjykata e Lartë me arsyetimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga gjyqtari i hetimit paraprak, ndaj edhe ai vendim nuk prodhon më efekte.

21.1.4 Gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me nevojën, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës, si dhe kanë mbajtur në konsideratë se ajo masë përmbush qëllimin për të cilin është caktuar. Gjykatat e posaçme, në thelb, kanë kontradiktë në vendimarrjet e tyre lidhur me ekzistencën e kushteve dhe të nevojave për caktimin e masës në rastin konkret. Ato kanë analizuar në mënyrë cilësore indiciet dhe provat që mbështesin kërkesën e Prokurorisë së Posaçme. Edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt sekuestrimi mund të jetë çdo e mirë (send), për këdo që i përket, përfshirë edhe një person që nuk ka lidhje me veprën penale, për sa kohë që ajo pasuri është e lidhur me atë vepër penale.

21.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së *pronës* në drejtim të *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, pasi masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale. Gjykatat kanë arsyetuar, në rastin konkret, rreth domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kufizimet/ndërhyrjet në të drejtat dhe liritë kushtetuese lidhur me pasurinë, si pasojë e caktimit të masës së sigurimit pasuror, janë rrjedhojë e baraspeshimit të drejtë midis interesit publik dhe



interesave personale të personave të prekur nga kjo ndërhyrje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

22. Fillimisht Gjykata vëren se objekti i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masës së sekuestros preventive për disa pasuri në emër të kërkuësve dhe të subjektit të interesuar, shoqërisë “5D”. Kërkuësit i kanë kundërshtuar këto vendime, duke paraqitur ankim kushtetues individual në datën 27.6.2025. Në datën 24.9.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen e shoqërisë “5D”, si subjekt të interesuar, e cila, në vijim, është njoftuar rregullisht për të paraqitur vetëm prapësimet që lidhen me objektin e kërkesës. Me parashtrimet e datës 30.10.2025, subjekti i interesuar, shoqëria “5D”, ka kundërshtuar procesin gjyqësor, objekt të ankimit kushtetues individual, duke ngritur pretendime për cenimin e të drejtave të tij kushtetuese për shkak të masës së sekuestros preventive për pasurinë e regjistruar në pronësi të këtij subjekti. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret, për ankimin kushtetues individual të kërkuësve, si dhe në situatën kur ky subjekt i interesuar edhe pse ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt të këtij gjykimi, nuk i është drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e tij me ankim kushtetues individual për sa masa e sekuestros ka prekur interesat e tij, vlerëson se kërkimet ngushtësisht personale të paraqitura nga ky subjekt nuk mund të merren në konsideratë. Kjo do të thotë se vendimet e kundërshtuara për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasuritë/kuotat e shoqërisë “5D” nuk janë pjesë e shqyrtimit të këtij gjykimi kushtetues, pasi për to kërkuësit nuk kanë paraqitur ndonjë pretendim.

23. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të

Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

24. Për verifikimin e këtyre kriterëve në çështjen konkrete, Gjykata evidenton fillimisht se kërkuësit, persona fizikë dhe juridikë, i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj tyre. Në këtë pikë vlen të mbahet në konsideratë se neni 16, pika 2, i Kushtetutës garanton të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara në të edhe për personat juridikë, për aq sa ato përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkuësit, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por edhe kanë provuar se pasojat e pretenduara në të drejtat e tyre kushtetuese kanë ardhur nga vendimet gjyqësore objekt kërkesë që kanë caktuar masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasuritë e tyre.

25. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata, edhe pse nuk e ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimeve për caktimin e masës së sekuestros së pasurisë, i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto lloj vendimesh, të cilat, pavarësisht se kanë karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, janë të afta të ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese të pronës private, ndërhyrje që vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Për sa kohë që pretendimet në ankimin kushtetues individual kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese, këto vendime konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).



26. Po kështu, kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuessit i kanë ngritur në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, edhe ky kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues konsiderohet i përmbushur.

27. Kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.12.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 3.3.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

28. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuessit kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masës së sekuestros preventive për disa pasuri, duke pretenduar se u janë cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të paanshmërisë, standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike), si dhe e drejta për pronë private, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

29. Pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, kërkuessit e kanë lidhur me gjykimin në shkallën e parë vetëm me praninë e prokurorit, si dhe me formën e gjykimit në dhomën e këshillimit dhe moslejimin e debatit për provat as në gjykatën e apelit, shkelje që, sipas tyre, nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkuessve, në rastin e masave të sigurimit me karakter pasuror, për sa kohë që ligjvënësi nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur

gjykimin në dhomën e këshillimit për këto kërkesa, duhet të zbatohen rregullat e përgjithshme të gjykimit. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se për sa kohë që për masat e sigurimit pasuror nuk ka rregullime të detajuara mbi ritin e gjykimit të tyre, gjykimi në shkallën e parë i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, me kusht që palët të njoftohen dhe të kenë mundësi për të paraqitur parashtrime 5 ditë përpara seancës. Sipas saj, në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit u ka dhënë mundësinë kërkuessve për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim për shkaqet e ngritura në apel. Për sa i takon gjykatës së shkallës së parë, me të vërtetë ka pasur një shkelje lidhur me ritin e gjykimit, por, ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ajo nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi në thelb nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore.

30. Gjykata ka pohuar se procedurat gjyqësore që vendosin për kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak, të cilat ndërhyjnë në të drejtat themelore, si rregull, duhet të sigurojnë garancitë e duhura të procesit të rregullt për individin. Megjithatë, ligji i ka kufizuar disa prej garancive të procesit të rregullt në këtë fazë në raport me ato të gjykimit të themelit. Nga ky këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se ligjvënësi në këto raste, duke mos parashikuar dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, si dhe duke mos i dhënë efekt pezullues ankimit, ka synuar që masa të tilla hetimore, sikurse janë edhe ato të sekuestros, të mos pengohen nga individit me anë të taktikave të ndryshme përmes fshehjes, zhdukjes ose tjetërsimit të sendit objekt sekuestroje. Në këtë mënyrë sigurohet efektiviteti i masës, për rrjedhojë edhe rezultati i procedimit penal në tërësinë e tij. Për këtë arsye, disa nga garancitë e procesit të rregullt realizohen në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit, e cila ka edhe kompetencën e marrjes dhe të shqyrtimit të provave, krahas zbatimit të ligjit, i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose janë zbatuar masat hetimore (*shih vendimet nr. 33, datë 20.5.2025; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së nenit 274 të KPP-së, që rregullon masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive, konstatohet se, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj,



ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sipas nenit 276 të KPP-së, kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros, cilido që ka interes mund të bëjë ankim, por kjo dispozitë nuk parashikon një formë të caktuar për shqyrtimin në këtë shkallë gjykimi.

32. Në rastin konkret, Gjkata vëren se gjykimi në shkallën e parë për caktimin e masës së sekuestros preventive ndaj pasurive në emër të kërkuësve është zhvilluar në seancë gjyqësore, por vetëm me praninë e prokurorit të çështjes. GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuësve lidhur me ritin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, duke e gjetur atë të pabazuar. Ajo gjykatë ka evidentuar se legjislacioni procedural penal nuk parashikon norma të detajuara mbi ritin e gjykimit të masave të sigurimit pasurore dhe, për këtë arsye, për to do të zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullimet ligjore të masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë duhet të kishte zbatuar pikën 1 të nenit 244 të KPP-së për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke vendosur gjykimin e saj në dhomën e këshillimit dhe në praninë e palëve. Megjithatë, sipas gjykatës së apelit, kjo mospërputhje e ritit të gjykimit të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë me pikën 1 të nenit 244 të KPP-së nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi, në thelb, nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore që të afektojë ligjshmërinë e tij ose të procesit. Po sipas saj, nuk mund të ketë kontradiktoritet në momentet e para të zbatimit të këtyre masave, për shkak se nga marrja dijeni do të pamundësohej zbatimi i tyre. Për sa i përket shqyrtimit të këtyre kërkesave në gjykatën e apelit, ajo gjykatë ka vlerësuar se duke qenë që gjykimi në shkallë të parë për këto lloj kërkesash shqyrtohet, si rregull, në dhomën e këshillimit, edhe shqyrtimi i ankimit nga ana e gjykatës së apelit realizohet, si rregull, në të njëjtën formë, për rrjedhojë ka vendosur që në rastin konkret ta shqyrtojë çështjen në dhomën e këshillimit. Pasi është njohur me ankimet, parashtrimet dhe provat e paraqitura nga palët, ajo gjykatë ka vlerësuar se çështja mund të shqyrtohej në gjendjen që ishin aktet në dhomën e këshillimit dhe se nuk kishte nevojë për caktimin e gjykimit në

seancën gjyqësore me praninë e palëve (*shih faqet 143–145, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

33. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka marrë në shqyrtim pretendimet për ritin e gjykimit në gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke arsyetuar se legjislacioni penal nuk ka rregullime të detajuara për shqyrtimin e masave të sigurimit pasurore të sekuestros preventive, në këto kushte, për to do të jenë të zbatueshme në mënyrë komplementare rregullimet e neneve 88, 244 dhe 245 të KPP-së. Legjislacioni procedural penal, sipas saj, ka parashikuar një regjim juridik të “thjeshtëzuar mbi bazë të dokumenteve” për t’u zbatuar në ato raste kur diktohet nevoja për marrjen e një vendimi brenda afateve të shpejta, me qëllim garantimin e efektivitetit në sjelljen e rezultatit që synojnë këto lloj masash. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka sjellë në vëmendje se vetë dispozitat normuese të sekuestros preventive parashikojnë afate të shkurtra si në drejtim të ankimit të vendimit, ashtu edhe në drejtim të dhënies së vendimit nga gjykata e apelit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në gjykimin e këtyre masave, KPP-ja nuk ka parashikuar fazën e verifikimit të tyre, pasi gjykohen nga gjykata e shkallës së parë dhe bëhen pjesë e shqyrtimit gjyqësor rishikues vetëm nëpërmjet sistemit të ankimeve, për rrjedhojë ka vlerësuar se pika 1 e nenit 244 të KPP-së zbatohet në mënyrë plotësuese për ritin e gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, sipas pikës 5 të nenit 426/a të KPP-së. Në vijim, Gjkata e Lartë ka vlerësuar se gjykimi në shkallë të parë i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin e sekuestros preventive shqyrtohet, si rregull, në dhomën e këshillimit dhe shqyrtimi i ankimit do të realizohet gjithashtu, si rregull, në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), me kusht që të zbatohen rregullat për këtë rit gjykimi (njoftimi paraprak i palëve), në mënyrë që të kenë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në apel/apel kundërshtues. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se, në ndryshim nga “oraliteti” dhe “publiciteti” që karakterizojnë procesin penal, në këto procese palëve u garantohet mundësia që të parashtrijnë argumentet dhe kundërshtimet e tyre me shkrim, në vend të parashtrimeve verbale. Pavarësisht këtij konkluzioni, Gjkata e Lartë ka theksuar se gjykata e apelit nuk ka asnjë pengesë që të disponojë për ritin e gjykimit, duke proceduar me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, sa herë që kryesisht ose me kërkesë të palëve, e



çmon të nevojshme dëgjimin e tyre ose verifikimin e mëtejshëm të pjesës faktike të çështjes. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka konstatuar se gjykata e apelit ka shqyrtuar ankimin e kërkuësve, duke i njoftuar ata paraprakisht për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, si dhe u ka dhënë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim. Më tej, sipas saj, pasi është njohur me apelet e palëve, ka vlerësuar se çështja mund të shqyrtohej në gjendjen që ishin aktet në dhomën e këshillimit, duke çmuar se nuk ka nevojë për caktimin e gjykimit në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për sa i përket mënyrës së procedimit të GJKKO-së Shkallës së Parë, ajo gjykatë ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit se shkelja e konstatuar nuk është e tillë që të cenojë vendimmarrjen e gjykatës për sa kohë nuk ka sjellë pasoja ligjore. Në vijim të këtij arsyetimi, ajo gjykatë i ka gjetur të pabazuara pretendimet e kërkuësve në lidhje me ritin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit (*shih paragrafët 29–33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

34. Në këto kushte, si dhe nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata rithekson se shqyrtimi në gjykatën e shkallës së parë nuk parashikon dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, garanci e cila realizohet në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore. Gjithsesi, ajo (Gjykata) vlerëson se, ashtu sikurse ka theksuar edhe Gjykata e Lartë, në rastin konkret kërkuësit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, duke realizuar në këtë shkallë të gjykimit garancitë e procesit të rregullt ligjor që lidhen me të drejtën e aksesit, si dhe me atë për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi atyre u është dhënë mundësia të paraqesin me shkrim parashtrimet dhe provat ku mbështesin pretendimet e tyre, pra u është dhënë mundësia që nëpërmjet avokatit të tyre të dëgjohen për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore dhe të marrin përgjigje për to. Po kështu, kërkuësit e kanë ushtruar lirisht edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, e cila ka marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të tyre në rekurs, duke i gjetur ato të pabazuara, duke lënë në fuqi, për

rrjedhojë, vendimin e gjykatës së apelit. Për këto arsye, pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit janë haptazi të pabazuara.

35. Për pretendimin e cenimit të *parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë*, kërkuësit kanë pretenduar se GJKKO-ja e Apelit ka shtuar si elemente mbështetëse për nevojat e sigurimit kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, duke rikualifikuar faktin penal sipas neneve 143, 287 dhe 334 të KP-së, ndërkohë që prokurori në kërkesën për caktimin e masës është mjaftuar me bashkëpunimin e thjeshtë. Ajo gjykatë ka tejkaluar rolin e saj duke e konfunduar me rolin e gjykatës së seancës paraprake. Përsëritja e të njëjtit qëndrim është tregues i qartë se GJKKO-ja e Apelit e ka shqyrtuar çështjen me bindjen se kërkuësi Redi Molla është fajtor dhe se veprat e kryera nga ai janë më të rënda se ato të pretenduara nga Prokuroria e Posaçme, duke e rënduar pozitën e tij. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi apo sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit ose kualifikimin e faktit penal, duke u udhëhequr nga një bindje e plotë se ai është fajtor dhe tenton ta orientojë Prokurorinë e Posaçme që të veprojë sipas bindjes së saj. Po e njëjta gjykatë ka mbajtur edhe herë të tjera këtë qëndrim, në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuësin Redi Molla, por në atë rast kjo parregullsi është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim. Për këtë argument të fundit kërkuësi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike.

36. Gjykata vëren se në thelb të pretendimit të kërkuësve, të cilin ata e ndërlidhin me cenimin e disa parimeve kushtetuese (parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit dhe atë të sigurisë juridike) është argumenti se GJKKO-ja e Apelit ka rënduar pozitën e tyre duke shtuar si nevojë siguri rrethanën e kryerjes së veprës në bashkëpunim të posaçëm, të papretenduar nga Prokuroria e Posaçme dhe se Gjykata e Lartë për këtë fakt, në rastin e caktimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuësit Redi Molla, e ka kthyer çështjen për rishqyrtim.

37. Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit ka orientuar Prokurorinë e Posaçme për të hetuar në



drejtim të bashkëpunimit si grup i strukturuar kriminal, pasi, duke pasur parasysh përmasën e fitimeve nga ushtrimi i këtij aktiviteti ekonomik, ajo gjykatë ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme se personat e hetuar ose jo deri më tani, mes tyre edhe kërkuesi Redi Molla, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuara nga paragrafi tretë i nenit 143 të KP-së, vepër penale kjo e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, sipas pikës 4, të nenit 28 dhe pikës 1, të nenit 334 të KP-së. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka konstatuar se fitimet kriminale të gjeneruara nga vepra penale janë ricikluar në qarkullimin civil dhe, sikurse ka konkluduar edhe në vendimin e datës 3.5.2024 (për vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit Redi Molla), sërish ka vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm që personat e proceduar penalisht ose të paproceduar ende, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga pika 2, e nenit 287 të KP-së, të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga pika 4, e nenit 28 dhe pika 1, e nenit 334 të KP-së. Megjithatë, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se hetimet kanë identifikuar një rreth tjetër personash të përfshirë, por të paproceduar, duke qartësuar ende më shumë përmasat e mëdha të shtrirjes së bashkëpunëtorëve. Në këto kushte, ajo gjykatë ka arsyetuar se mbetet detyrë kushtetuese e organit procedues që në vijim të hetimeve të ketë në fokus procedimin penal të secilit bashkëpunëtor dhe veprimin e një grupi të strukturuar kriminal si operator ekonomik pjesëmarrës në prokurime publike (*shih paragrafët 257–261, faqet 146, 147, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ndonëse formalisht pretendimi i kërkuesve qëndron, ka çmuar se, në thelb, nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme lidhur me ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

38. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale të cilat kryhen nga organi procedues, pasi individit merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Edhe në raste të ngjashme,

Gjykata është shprehur se GJKKO-ja e Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, por ka vlerësuar në mënyrë autonome rëndësinë e fakteve konform natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohet. Arsyetimi i gjykatës nuk përbën rëndim të pozitës të të pandehurit, pasi është organi i akuzës ai që vlerëson gjatë hetimit paraprak se për cilat vepra penale do të ngrëjë përfundimisht akuzë (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe në rastin në shqyrtim, ashtu sikurse arsyeton edhe Gjykata e Lartë, nuk rezulton që gjykatat e posaçme të kenë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të nenit 274 të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ato të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar, në rastin konkret, pozitën e kërkuesit. Prandaj, pretendimi i kërkuesve për secilin prej parimeve kushtetuese se pretendon se i është cenuar nuk mund të merret në shqyrtim.

40. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* dhe *së drejtës së pronës*. Gjykata, duke qenë se në jurisprudencën e saj ka pohuar se për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të *subsidiaritetit* u takon edhe atyre respektimi i standardeve kushtetuese (*shih vendimet 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe bazuar edhe në thelbin dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, do të shqyrtojë, në vijim, *në aspektin substancial*, pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

41. Kërkuesit kanë pretenduar se masa e sekuestros preventive nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së, sipas të cilit duhet të provohet lidhja e sendit për të cilin kërkohet të vendoset masa e sigurimit pasuror me veprën penale, pasi nuk ka asnjë indicie ose provë për të arritur në konkluzionin që pasuritë janë produkte të veprës penale. Lidhur me kuotën e kërkueses, shoqërisë “Restur”, nuk është hetuar dhe as arsyetuar se ku është dyshimi që kjo pasuri mund të jetë krijuar nga produktet e



veprës penale. Lidhur me kërkuesen, shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, rezulton se nga krijimi i saj e deri në vitin 2023 nga ana e të ndjerit S. M. është kaluar në shoqëri vlera 564.000 euro në kuadër të zhvillimit të projektit, e cila nuk është verifikuar për burimin e saj, që të përligjte vënien e sekuestros mbi të. Ndërhyrja në të drejtën e pronës private është shtrirë përtej personit nën hetim, vetëm për shkak të lidhjes familjare dhe në mungesë të plotë të të dhënave ose të një analize nga gjykatat. Në këtë kuptim, është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë nr. 5/523. Kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuesve është bërë përmes një mjeti të papërshtatshëm, siç është sekuestroja preventive, në kushtet kur qëllimi i kërkuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihet me mënyra të tjera, si ndalimi i tjetërsimit të pasurive dhe i kuotave të sekuestruara, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe në regjistrin tregtar. Kërkuesi Redi Molla është i kufizuar nga disponimi i pasurive edhe si pasojë e kufizimit të lirisë. Gjykatat nuk kanë paraqitur një lidhje të qartë midis pasurive të sekuestruara dhe veprës penale, dhe nuk kanë specifikuar se në cilën prej kategorive të nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së përfshihen sendet e sekuestruara. Duke pasur parasysh faktin se disa nga pasuritë e sekuestruara janë në pronësi të personave të tretë që nuk kanë lidhje me procedimin penal (kërkuesja Ollga Molla), organi i akuzës dhe gjykatat duhet të kishin arsyetuar me argumente konkrete arsyet e vendosjes së sekuestros për këto pasuri. Gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme mbi kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit pasuror, duke mos arsyetuar se pse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë ishte mjeti i vetëm për të siguruar qëllimin e synuar, në kuptim të parimit të proporcionalitetit. Çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim dhe, sidomos atyre që nuk janë nën hetim, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja duhet të urdhërohet si mjeti i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë. Për shkak të masës është cenuar edhe e drejta për pronë private, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ndërhyrja nuk është e bazuar në ligj (sepse legjislacioni penal lejon kufizimet e kësaj të drejte vetëm ndaj personave që dyshohet se

kanë kryer veprën penale), dhe as nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë (pasi nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së).

42. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale. Gjykatat kanë arsyetuar në rastin konkret rreth domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, si dhe kanë mbajtur në konsideratë se masa e sigurimit pasuror përmbush qëllimin për të cilin është caktuar. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kufizimet/ndërhyrjet në të drejtat dhe liritë kushtetuese lidhur me pasurinë, për shkak të caktimit të masës së sigurimit pasuror, janë rrjedhojë e baraspeshimit të drejtë midis interesit publik dhe interesave personale të personave të prekur nga kjo ndërhyrje. Gjykatat e posaçme, në thelb, kanë kontradiktë në vendimmarrjet e tyre lidhur me ekzistencën e kushteve dhe të nevojave për caktimin e masës në rastin konkret. Ato kanë analizuar në mënyrë cilësore indiciet dhe provat që mbështesin kërkesën e Prokurorisë së Posaçme. Edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt sekuestrimi mund të jetë çdo e mirë (send), për këdo që i përket, përfshirë edhe një person që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që ajo pasuri është e lidhur me krimin. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes është i pabazuar, pasi masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale.

43. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata fillimisht vëren se masa e kundërshtuar e sekuestros preventive është marrë në kuadër të procedimit penal, mbi dyshimet se kërkuesi Redi Molla ka marrë përfitime të parregullta përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin publik, për vete ose persona të tjerë, se ka bërë deklaram të rremë dhe ka fshehur pasurinë, si dhe ka kryer veprime, me qëllim fshehjen ose mbulimin e



originës së pasurisë së paligjshme, të përfutur si pasojë e korrupsionit ose burimeve të tjera të paligjshme. Në rastin konkret, masa e sekuestros preventive për pasuritë e paluajtshme e të luajtshme të kërkuarit Redi Molla dhe kërkuarës Ollga Molla ka vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën për gëzimin dhe disponimin e këtyre pasurive, për rrjedhojë ka sjellë kufizim të së drejtës së tij kushtetuese të pronës private.

45. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se ndërhyrja që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës duhet: të jetë e ligjshme, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; të vendosë një “ekuilibër të drejtë” midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës; të respektojë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. E drejta e pronës private, ashtu si dhe të drejtat dhe liritë e tjera, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), i cili përfshin, mes të tjerash, edhe detyrimin për një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në lidhje me këtë standard kushtetues, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet

domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.6.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se në rastet kur pretendohet se vendimet gjyqësore objekt kontrolli përmbajnë elemente arbitrariteti, Gjykata nuk vë në dyshim të drejtën e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, por kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore e faktike të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit (që mbeten për t'u zgjidhur në sferën e gjykimit të gjykatave të zakonshme), por që gjithsesi cenojnë të drejtën e kërkuarit për të pasur një gjykim të drejtë (*shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në kuptim të këtyre standardeve kushtetuese dhe bazuar në pretendimet e ngritura nga kërkuarit në çështjen konkrete, Gjykata do të analizojë nëse gjykatat e posaçme, në vendimet për caktimin e masës së sekuestros, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë si për lidhjen e kësaj mase me objektivin e saj, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale, ashtu edhe për respektimin e kriterëve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të pronës private.

49. Bazuar në sa më sipër, Gjykata nuk vë në dyshim se lufta kundër kriminalitetit është një



çështje me interes publik, si një nga kriteret që justifikon ndërhyrjen në të drejtat themelore të individit, përfshirë atë të pronës private dhe se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarevajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale. Duke pasur në konsideratë prezumimin e ekzistencës së interesit publik për ndërhyrjen në të drejtat themelore, por edhe hapësirën e kontrollit kushtetues, si mjeti i fundit i brendshëm në dispozicion të individit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore, që shtrihet në verifikimin e respektimit të garancive procedurale të përshtatshme dhe efektive për mbrojtjen nga arbitrariteti në ushtrimin e pushtetit publik që çojnë në shkeljen e të drejtave substanciale, si dhe rolin e saj subsidiar, ajo ndalet në vlerësimin nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë.

50. Për shkak se masa e sekuestros me karakter pasuror përbën një mjet kontrolli të pasurisë së individit nga shteti dhe, në disa raste, për nga kohëzgjatja, mund të përbëjë edhe heqje të saj, si dhe duke pasur parasysh garancitë procedurale që duhet të sigurohen në këtë fazë të procedurave penale, arsyetimi i vendimeve gjyqësore i lejon palës së prekur jo vetëm që të njihet me shkaqet e kufizimit të së drejtës substanciale, por edhe që ta kundërshtojë këtë masë efektivisht përpara gjykatave më të larta. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për sekuestrimin e pasurive të kërkuarve objekt ankimi përmbajnë bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të justifikuar këtë ndërhyrje në të drejtën e pronës.

51. Gjykata në jurisprudencën e saj është ndalur edhe në natyrën dhe pasojat e sekuestros preventive, që rregullohet nga parashikimet e neneve 274–276 të KPP-së dhe që synon heqjen e sendit nga disponimi i lirë i subjektit që e zotëron atë, duke vendosur mbi të (sendin) një detyrim të caktuar. Sipas nenit 274 të KPP-së, sekuestroja vendoset nga gjykata, me kërkesë të prokurorit, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ashtu edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo

lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së. Sekuestroja preventive ka qëllim parandalues, pra synon të ndërpresë kryerjen e një veprë penale ose të parandalojë kryerjen e veprave penale të reja. Nga ana tjetër, kjo masë synon të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm të mëvonshëm, duke bërë paraprakisht të padisponueshme, në një fazë që i paraprin dënimit, sendet që kanë shërbyer ose kanë qenë të destinuara për të kryer veprën penale, që janë produkti ose të ardhurat, ose sendet, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbën veprën penale (sekuestroja e drejtpërdrejtë). Sekuestroja preventive vendos një pengesë/kufizim mbi sendin, me qëllim garantimin e arritjes së qëllimit të procedimit penal deri në marrjen e vendimit përfundimtar të fajësisë së autorit të veprës penale. Sekuestroja preventive mund të urdhërohet jo vetëm mbi sendet që kanë një lidhje specifike me faktin penal që ndiqet penalisht, por edhe “për ekuivalencë”, pra edhe mbi çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale (neni 36, pika 1, shkronja “ç”, i KP-së). Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, sikundër praktikës gjyqësore, është e pranueshme që masa kufizuese e sekuestros të prekë edhe sende ose pasuri, origjina e të cilave nuk vihet në diskutim në atë procedim penal, të cilat janë fituar ose kanë ekzistuar edhe përpara fakteve penale për të cilat ka filluar procedimi penal, në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros, pra që nuk kanë një lidhje të posaçme me faktet objekt të veprës penale. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se për të respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit me ligj dhe standardet e gjykimit të drejtë, prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe gjykatat e zakonshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e saj, duhet të specifikojnë dhe të saktësojnë se në cilën prej kategorive, sipas nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së, përfshihet secili prej sendeve që kërkohet të sekuestrohet, pra nëse bëhet fjalë për sende ose produkte të veprës penale (sekuestroja e drejtpërdrejtë) ose për sekuestrim “për ekuivalencë” të sendeve të tjera që nuk hyjnë në kategorinë e atyre që lidhen drejtpërdrejt me veprën penale. Në rastin kur, për shkak se është e pamundur të rikuperohen sendet e vendosura në mënyrë të paligjshme, kërkohet aplikimi i shkronjës “ç të pikës 1 të nenit 36 të KP-së, është e nevojshme të saktësohet individualisht çdo send/pasuri që sekuestrohet për



shkak të ekuivalencës së vlerës së tij me atë të produkteve të veprës penale. Për këtë qëllim nevojiten të kryhen disa veprime që kanë të bëjnë si me vlerësimin se sendi/produkti i veprës penale është i pamundur të gjendet ose të rikuperohet, ashtu edhe me vlerësimin e secilit send që kërkohet të sekuestrohet “për ekuivalencë” për të konkluduar masën në të cilën është e nevojshme të shtrihet sekuestroja (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Për rrjedhojë, sekuestroja “për ekuivalencë”, në ndryshim nga sekuestroja e drejtpërdrejtë e sendeve/produkteve të veprës penale, duke mos qenë e identifikueshme për shkak të lidhjes me vetë veprën, kërkon zbatimin e disa filtrave që kanë të bëjnë me: i. zbatimin e saj vetëm kur është e pamundur të identifikohen ose të gjenden sendet që lidhen me veprën penale; ii. ajo duhet të shtrihet, për aq sa është e mundur, në pasuri të të njëjtit lloj; iii. duhet të synojë të jetë sa më pak e dëmshme në kuptim të qëllimit që synon të arrijë. Kjo e fundit kërkon nga gjykatat që të saktësojnë se mbi cilat tagra mund të shtrihet kufizimi dhe nëse sekuestrimi i plotë i sendit, pra kufizimi i së drejtës së pronës në të gjitha tagrat e saj, përputhet me qëllimin e kësaj mase dhe nëse, në kuptim të kriterit të proporcionalitetit, në drejtëm të përshtatshmërisë së masës, qëllimi që synohet të arrihet nuk do të ishte i mundur të përmbushej edhe përmes kufizimit vetëm të një ose më pak tagrave të së drejtës së pronës. Në ato raste kur është e zbatueshme sekuestroja “për ekuivalencë” gjyqtari duhet të arsyetojë në mënyrë të përshtatshme pamundësinë e arritjes të të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vet së drejtës substanciale të pronës private (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në përputhje jo vetëm me parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, por edhe të prezumimit të pafajësisë, çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim gjatë procedurave penale, pra përpara dhënies së një vendimi përfundimtar të fajësisë, duhet të arsyetohet në drejtëm të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja, si çdo masë tjetër që kufizon ushtrimin e lirë të të drejtave të garantuara kushtetutshmërisht, duhet të urdhërohet vetëm si mjeti i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet

të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë. Kjo nënkupton se prokurori në kërkesën për caktimin e masës dhe më pas gjykata gjatë shqyrtimit të saj duhet të verifikojnë dhe të arsyetojnë se sekuestroja që shtrihet mbi sende të tjera që nuk kanë lidhje me veprën penale dhe vetë vlera e sendeve të sekuestruara “për ekuivalencë” është proporcionale me “çmimin” ose “fitimin” e veprimtarisë së paligjshme, me qëllim shmangien e një kufizimi arbitrar të së drejtës së pronës private. Edhe pse këto masa kufizuese gjejnë mbështetje kushtetuese (nenet 41 dhe 17 të Kushtetutës), pasi synojnë realizimin e një interesi publik, në mënyrë që dëmi në të drejtat individuale të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Kufizimi nuk mund të shkojë përtej asaj që synohet dhe që është e nevojshme për realizimin e qëllimit të parashikuar nga dispozitat penale dhe duhet t'i përgjigjet masës së proporcionalitetit në kuptim të *quantum* të pasurisë/të ardhurave që burojnë nga veprimtaria e paligjshme. Çdo tejkallim, në mungesë të analizës së këtyre elementeve, do të përbënte cenim të vet thelbit të së drejtës së pronës private, duke e bërë ndërhyrjen arbitrare (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Si parim, masa e sekuestros preventive synon të prekë sendin që dyshohet se është fituar në mënyrë të paligjshme dhe vetëm nëse është e pamundur të gjendet ose të rikuperohet ai, atëherë synohet që të rikuperohen pasuri të tjera, vlera e të cilave u korrespondon atyre të produkteve të veprës penale. Kjo nënkupton se zbatimi i sekuestros së drejtpërdrejtë mbi vetë produktet e veprës penale ose të ardhurat e saj nuk lejon edhe zbatimin në të njëjtën kohë dhe paralelisht, pra për të njëjtin qëllim, edhe të sekuestros “për ekuivalencë” të pasurive të tjera të individit, subjekt i procedimit penal (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Duke pasur parasysh qëllimin e sekuestros “për ekuivalencë”, si një masë që i paraprin konfiskimit të pasurisë, ajo duhet të synojë atë lloj sendi/aseti që është në gjendje të realizojë më lehtë ekuivalencën në vlerë me produktet e veprës penale. Nga ana tjetër, për sa kohë që masa shtrihet mbi sende të tjera, të ndryshme nga sendi ose produktet e veprës penale, pra sende për të cilat nuk verifikohet dhe as nuk certifikohet në atë procedim penal ligjshmëria e burimit të tyre, duhet të synohet të



preken sa më pak tagra të sendit, në mënyrë që kjo masë, nga njëra anë, të jetë sa më pak e dëmshme për individin dhe, nga ana tjetër, të sigurojë qëllimin e saj, që është ai për të shmangur tjetërsimin/humbjen e sendeve në pritje të përfundimit të procesit penal. Për këtë qëllim prokuroria duhet të argumentojë në mënyrë të qartë përpara gjykatës se çfarë ka rezultuar nga hetimi, mënyrën sesi po veprohet dhe vlerësimin e kryer për të konkluduar si për vlerën e produkteve/ sendeve/të ardhurave të dyshuara të veprës penale, ashtu edhe për vlerën e tyre korresponduese me atë të sendit për të cilin kërkohet nga gjykata caktimi i masës kufizuese, sikundër tagrat që synohen të preken/kufizohen në kuptim të proporcionalitetit të ndërhyrjes. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme duhet të tregojnë kujdes në zbatimin e nenit 274 të KPP-së të lidhur me nenin 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së, duke bërë, për aq sa është e mundur, vlerësimin e mënyrës së zbatimit të këtyre dispozitave në drejtim të ekuivalencës me produktet e dyshuara të veprës penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Thënë sa më sipër, në rastin konkret, Gjykata do të ndalet, në vijim, në mënyrën sesi gjykatat e posaçme kanë zbatuar kriteret e mësipërme në vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë që janë vlerësuar se përbëjnë produkte të veprave penale dhe atyre që janë sekuestruar si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale, si dhe në mënyrën sesi kanë argumentuar ato në drejtim të kufizimit të së drejtës së pronës private të kërkuesve për shkak të kësaj mase.

57. Gjykata vëren se në kuadër të procedimit penal është formësuar dyshimi i arsyeshëm se gjatë kohës që ka ushtruar funksionin publik, kërkuesi Redi Molla ka konsumuar veprat penale të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të KP-së (shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike dhe korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike). Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga nenet 257/a, paragrafi i dytë, dhe 25 të KP-së (refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave që kanë detyrimin ligjor për deklarim), ka lindur dyshimi për fshehje të faktit se kërkuesi Redi Molla, së bashku me shtetasin M. Q., kanë në zotërim të tërthortë subjektin e interesuar, shoqërinë “5D”, si dhe dyshimi se ai zotëron në

mënyrë të fshehtë pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të prindërve të tij. Për këto dyshime, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar, ndër të tjera, sekuestrimin e interesave pasurorë të kërkuesit Redi Molla në dy shoqëri tregtare, sikundër të dy pasurive të paluajtshme, në pronësi të prindërve të tij. Duke qenë se pasuritë e sekuestruara të shoqërisë “5D” nuk janë objekt i këtij ankimi kushtetues individual (*shih sipër paragrafin 22*), Gjykata, në vijim, do të ndalet në analizën e gjykatave të posaçme për pasuritë e tjera të sekuestruara.

58. Në lidhje me *dy pasuritë e paluajtshme* (nr. 5/523 dhe nr. 5/648) të ndodhura në Tiranë, në pronësi të prindërve të kërkuesit Redi Molla, të sekuestruara nga Prokuroria e Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konsideruar se ka të dhëna të mjaftueshme se përbëjnë *produkte të veprave penale objekt procedimi*, pasi ato janë fituar pjesërisht me burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale (nga fonde të shoqërisë “5D”). Për to është vlerësuar se plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274/1 i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja “b”, i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Në këtë konkluzion është arritur pasi është vlerësuar se ka rezultuar e provuar që: i. dy këste të blerjes së këtyre pasurive janë paguar nga shoqëria “5D” (administruar mandatpagesa për këstin e dytë në vlerën 100.000 euro, me objekt “*pagesë kësti 2 për blerje pasuritë nr. 5/523 dhe nr. 5/648, me adresë “Pazari i ri” Tiranë*”; ii. kanë rezultuar të dhëna të nevojshme dhe të mjaftueshme për të konkluduar se shoqëria “5D” kontrollohet plotësisht nga kërkuesi Redi Molla dhe duke mbartur interesa të fshehur në këtë person juridik, ka dyshime të arsyeshme se këto dy pasuri jo vetëm janë blerë pjesërisht me vlera monetare nga shoqëria “5D”, por edhe se përbëjnë pasuri të fshehura të tij. Në këtë konkluzion është arritur, pasi: i. të paktën dy këste në vlera të konsiderueshme janë paguar nga shoqëria e cila mbart interesa të drejtpërdrejtë pasurorë kërkuesi Redi Molla; ii. ai njihet nga qiramarrësit e pasurive si pronar i tyre; iii. ato janë rikonstruktuar, duke investuar vlera të konsiderueshme, po nga shoqëria “5D”, e lidhur me dhe në të cilën mbart interesa kërkuesi Redi Molla (*shih paragrafin 97.3, faqja 87, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Pavarësisht se neni 36, paragrafi 2, i KP-së parashikon se nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale, në rastin konkret është



arsyetuar se nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre, pavarësisht burimit të vlerës për pjesën tjetër të blerjes, pasi i përket organit të akuzës në vijim të hetimeve të qartësojë nëse e gjithë vlera e tyre vjen si pasojë e transformimit të produktit të tyre të dyshuar të veprës penale, ose që vetëm një pjesë e saj, duke u saktësuar kjo vlerë (*shih paragrafin 97.4, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Lidhur me faktin se këto pasuri të paluajtshme janë në pronësi të prindërve të kërkuesit Redi Molla, pra jo ligjërisht në pronësi të tij, nuk është konsideruar si pengesë për sekuestrimin e tyre, me arsyetimin se ka lidhje të mjaftueshme mes tyre dhe veprave penale objekt procedimi (*shih paragrafin 97.5, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Për këto pasuri, duke qenë se rezultojnë të jenë produkte të prejardhura të veprës penale në kuptim të nenit 36, pika 2, të KP-së, përbëjnë një rrezik real dhe prezent për transferimin e tyre tek të tretët, me qëllim shmangien e konfiskimit. Ky transferim mund të ndodhë në çdo kohë, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre, duke qenë se janë të regjistruara në emër të të tretëve dhe jo personave nën hetim, duke rënduar kështu pasojat e veprës penale (*shih faqen 90, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

59. Me të njëjtat argumente edhe GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274, paragrafi 1, i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja “b”, i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Ajo gjykatë ka vlerësuar se nga të dhënat deri në atë moment të procedimit penal provohej se pasuritë e sekuestruara e kanë origjinën nga fondet e shoqërisë “5D”, për rrjedhojë, sipas saj, nuk ka asnjë dobi vërtetimi i aftësisë paguese të kërkuesve Redi dhe Ollga Molla, ose aftësia e tyre pasurore për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara të ndër vite nga shoqëria “5D” (*shih faqen 150, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

60. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cënueshme. Lidhur me pretendimet se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, ajo gjykatë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri e një

personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se pavarësisht se në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

61. Kërkuesit në ankimin kushtetues individual kanë pretenduar se ndalimi i tjetërsimit të këtyre pasurive, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme do të ishte e mjaftueshme për të arritur qëllimin e synuar nga neni 274 i KPP-së; se kërkuesi Redi Molla, pjesën takuese në pasuritë e paluajtshme e ka fituar si pasojë e trashëgimisë nga i ndjeri, i ati i tij; se Prokuroria e Posaçme nuk ka hetuar dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar se ku është dyshimi që këto pasuri mund të jenë krijuar nga produktet e veprës penale, kur origjina e tyre është e qartë. Nuk është verifikuar burimi i të ardhurave të kërkuesit Redi Molla dhe as i familjarëve të tij. Në vendimet gjyqësore nuk arsyetohet se përse është sekuestruar edhe pjesa takuese e kërkueses Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim. Nga ana tjetër, masa është joproportionale, pasi pagesa e pretenduar prej 100.000 eurosh dhënë nga shoqëria “5D” është bërë vetëm për pasurinë me nr. 5/648, ndaj është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë me nr. 5/523, për të cilën ka vetëm aludime dhe indicie. Nga analiza financiare e kërkuesve rezulton se burimi i të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive të paluajtshme (në shumën 37.218.000 lekë) janë të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme nr. 6/257, sipas kontratës nr. 1683 rep., nr. 675 kol., datë 8.4.2019, në shumën 380.000 euro (47.787.000 lekë, konvertuar me kursin e kohës).

62. Për sa më sipër, Gjykata vëren se në rastin konkret masa e sekuestros është vendosur nga gjyqtari i hetimeve paraprake mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa vendimi i tij dhe zbatimi i masës në vijim i është nënshtruar kontrollit nga gjykatat më



të larta. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me arsyet e vendosjes dhe të zbatimit të masës së sekuestrimit për pasuritë që janë vlerësuar se përbëjnë produkte të veprave penale objekt procedimi, në përputhje me nenin 274 të KPP-së. Konkretisht, gjykatat kanë arsyetuar lidhur me: i. ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova; ii. lidhjen e mjaftueshme me veprën penale, për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla; iii. rrezikun se disponimi i lirë i sendit ose i objektit që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës (*shih paragrafët 5–7 të vendimit*). Referuar arsytimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, në drejtim të mënyrës së interpretimit dhe të zbatimit të nenit 274 të KPP-së, si baza ligjore e zbatueshme edhe në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykatat e posaçme i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për sa u takon pretendimeve për ligjshmërinë dhe proporcionitetin e masës së sekuestrimit të vendosur mbi pasuritë e konsideruara se përbëjnë produkte të veprave penale objekt procedimi, duke arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim. Arsyetimi i tyre nuk duket të jetë i paarsyeshëm në aspektin kushtetues, në kuptimin që nuk përmban gabime të dukshme ligjore ose faktike.

63. Lidhur me pretendimin se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri e një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Prandaj Gjykata, sikurse ka theksuar edhe në raste të ngjashme (*shih vendimin nr. 33, datë 20.5.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se, ashtu sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, ky fakt nuk është i rëndësishëm për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në kuadër të një procedimi penal dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij për një pasuri të dyshuar se është e lidhur me veprën penale për të cilën po hetohet.

64. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi kërkuesve për pasuritë (nr. 5/523 dhe nr. 5/648) të ndodhura në Tiranë nuk është i bazuar.

65. Në lidhje me shoqërinë “Restur”, përfshirë pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë “Mediterranean Investment Group”, gjykatat e posaçme kanë vlerësuar se ka vend që të sekuestrohen *si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale* për të cilat procedohet kërkuesi Redi Molla, për aq sa mund të përcaktohet në këtë fazë të procedimit. Në kushtet kur rezulton se shoqëria “Restur” dhe çdo pasuri e saj është në pronësi të kërkuesit Redi Molla, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre si sende/të drejta që përmbushin vlerën ekuivalente të produktit të veprës penale, në kuptim të nenit 274, paragrafi 2, të KPP-së dhe nenit 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së, duke lënë detyrë që në vijim të hetimeve të saktësohet edhe vlera e produktit në raport me vlerën e sendit /asetit të sekuestruar për të përmbushur vlerën ekuivalente të tij (*shih paragrafin 97.6, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Pavarësisht se kërkuesi Redi Molla është nën masë sigurimi personal, është çmuar se tjetërsimi i të drejtave pasurore mbi këto shoqëri rrezikon të realizohet përmes përfaqësimit, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre.

66. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se nuk ka asnjë utilitet provues solvabiliteti i kërkuesve Redi dhe Ollga Molla ose aftësia e tyre pasurore për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria “5D” (*shih faqen 150, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Ndërsa Gjykata e Lartë, ndonëse nuk është shprehur në mënyrë specifike për sekuestron e vendosur si vlerë ekuivalente të produkteve të veprave penale, ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestrimit preventive duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cenueshme. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se pavarësisht se në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestrimit preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafët 39 dhe 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).



67. Kërkuesit kanë pretenduar se qëllimi i synuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihej me masa të tjera më të përshtatshme, si ndalimi i tjetërsimit të këtyre pasurive, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin tregtar. Shoqëria “Restur” është krijuar në datën 1.9.2020, me kapital themeltar në vlerën 100 lekë dhe në harkun kohor 23.9.2020–29.3.2023 nga i ndjeri S. M. kanë kaluar 564.000 euro në llogarinë e shoqërisë. Nga analiza financiare e kërkuesve rezulton se burimi i të ardhurave për investimin e bërë në aktivitetin tregtar, janë: i. të ardhura në vlerën 8.519.635 lekë si kompensim financiar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave; ii. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 352/4, sipas kontratës së shitblerjes nr. 3107 rep., nr. 1080 kol., datë 11.8.2020, paguar në dy këste (10.000.000 lekë dhe 20.999.900 lekë); iii. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 102/23+1-5, sipas kontratës së shitblerjes nr. 1469, nr. 998/4 kol., datë 27.6.2019, në shumën 2.232.920 lekë; iv. të ardhura nga shitja e pasurisë truall me nr. pasurie 24/227, sipas kontratës së shitjes nr. 3962 rep., nr. 1375 kol., datë 25.9.2020, në vlerën 150.000 euro (18.615.000 lekë sipas kursit të këmbimit të kohës); v. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 352/4, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. 3107 rep., nr. 1080 kol., datë 11.8.2020, në shumën 20.999.900 lekë; vi. të ardhura nga kthimi i huas, sipas transfertës bankare të datës 28.3.2023, në shumën 75.000 euro (referuar kontratës së huas, datë 28.3.2023, me shtetasin D. K.). Kërkuesit kanë pretenduar se këtë analizë financiare nuk kanë arritur ta paraqesin në gjykatën e apelit për shkak të afatit të shkurtër për të paraqitur ankim, megjithatë e kanë paraqitur së bashku me rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, me qëllimin për të provuar se prindërit e kërkuesit Redi Molla kanë pasur mundësi financiare për të përballuar investimet për periudhën e analizuar. Për këto pretendime Gjykata e Lartë ka arsyetuar se dalin jashtë juridiksionit të saj, pasi duke qenë të lidhura me analizë provash dhe fakti, janë atribut i gjykatave të faktit.

68. Për sa më sipër, pas shqyrtimit të këtij pretendimi të kërkuesve, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të

nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

69. *Sipas njërit qëndrim*, kërkesa duhej pranuar pjesërisht, pasi pretendimi i kërkuesve për cenimin e të drejtës së pronës në aspektin procedural të saj, në lidhje me masën e sekuestros së vendosur mbi shoqërinë “Restur”, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara “për ekuivalencë”, është i bazuar¹.

70. Konkretisht, për sa i takon përshtatshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata ka vlerësuar se masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të prekur, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, sipas këtij qëndrimi, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, për masën e sekuestros të vendosur mbi shoqërinë “Restur”, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara për ekuivalencë, nuk rezulton që gjykatat e posaçme të kenë analizuar nëse qëllimi i parashikuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihej me masa të tjera më pak kufizuese. Ndërkohë, kërkuesit kanë pretenduar se qëllimi i synuar nga kjo masë mund të arrihej, për shembull, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për tjetërsimin e tyre në regjistrat përkatës publikë, masë që, sipas tyre, do të ishte më proporcionale. Për më tepër, GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar të panevojshëm verifikimin e aftësive paguese të kërkuesve për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, me arsyetimin se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria “5D”. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuesve për shpërpjesëtimin e masës, duke arsyetuar se, në rrethanat e rastit

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahim.



konkret, kufizimi i të drejtave kushtetuese për shkak të vendosjes së masës së sigurimit të karakterit pasuror është rrjedhojë e një baraspeshimi të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave themelore kushtetuese individuale të personave/subjekteve të prekur nga ndërhyrja, si dhe se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk evidentojnë që masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë të jenë dukshëm arbitrare ose joproporcionale.

71. Për sa më sipër, sipas këtij qëndrimi, nuk rezulton se gjykatat e posaçme kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme lidhur me elementin e përshtatshmërisë së ndërhyrjes së masës së sekuestros preventive të vendosur mbi shoqërinë “Restur”, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara për ekuivalencë mbi pasuritë e kërkuesve. Madje, GJKKO-ja e Apelit ka refuzuar të marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve lidhur me aftësitë paguese, që, sipas tyre, do të vërtetonin se ata i justifikonin me të ardhura të ligjshme pasuritë e sekuestruara, duke arritur *apriori* dhe pa ndonjë analizë konkrete në përfundimin se secila prej pasurive të sekuestruara e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria “5D”. Edhe Gjykata e Lartë, ndonëse formalisht e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuesve, duke arsyetuar se masa është rrjedhojë e një baraspeshimi të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave individuale të personave/subjekteve të prekur nga ajo, nuk rezulton t’i jetë përgjigjur pretendimit se përse qëllimi i synuar nga kjo masë nuk mund të arrihej, për shembull, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për tjetërsimin e tyre në regjistrat përkatës publikë, që do të ishte një masë më proporcionale.

72. Ndërsa në drejtim të ashpërsisë së ndërhyrjes, Gjykata ka pohuar se gjykatat e zakonshme, në çdo rast, duke pasur në vëmendje si mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, ashtu edhe standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, duhet të bëjnë kujdes për të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese respektimin e këtij kriteri në drejtim të secilit prej tagrave të së drejtës së pronës së individit ndaj të cilit

vendoset kufizimi i pasurisë (*shih vendimin nr. 33, datë 20.5.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Duhet ritheksuar se për masën e sekuestros “për ekuivalencë” – si një masë që shtrihet mbi sende të tjera, të ndryshme nga sendi ose produktet e veprës penale, pra sende për të cilat, nuk verifikohet dhe as nuk certifikohet në atë procedim penal ligjshmëria e burimit të tyre – Gjykata është shprehur se duhet të synohet të preken sa më pak tagra të sendit, në mënyrë që kjo masë, nga njëra anë, të jetë sa më pak e dëmshme për individin dhe, nga ana tjetër, të sigurojë qëllimin e saj, që është shmangia e tjetërsimit/humbjes së sendeve në pritje të përfundimit të procesit penal. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme duhet të tregojnë kujdes në zbatimin e nenit 274 të KPP-së të lidhur me nenin 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së, duke bërë, për aq sa është e mundur, vlerësimin e mënyrës së zbatimit të këtyre dispozitave në drejtim të ekuivalencës me produktet e dyshuara të veprës penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

73. Një analizë e analizë e tillë mbi tagrat që synohen të preken apo kufizohen në kuptim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, mungon në vendimet gjyqësore objekt gjykimi. Edhe pse me anë të vendosjes së këtyre pasurive nën administrimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara nënkuptohet se kërkuesve u janë kufizuar të tri tagrat e pronësisë, sipas këtij qëndrimi, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk rezulton të kenë arsyetuar mjaftueshëm në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, për pamundësinë e arritjes së të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vetë të drejtës substanciale të pronës private. Në këto kushte, në mungesë të arsyetimit të këtij elementi nga gjykatat e posaçme dhe të riparimit të kësaj mangësie nga Gjykata e Lartë, është e pamundur të verifikohet nëse masa e sekuestros preventive, e vendosur mbi pasuritë që përbëjnë vlerën ekuivalente të asaj që dyshohet se është përfituar nga veprat penale (mbi shoqërinë “Restur”, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit), e tejkalon ose jo kriterin



e ashpërsisë së masës në rastin konkret, në kuptimin që të verifikohet nëse qëllimi që synohet të arrihet mund të përmbushej edhe përmes kufizimit vetëm të njërit ose disa prej tagrave të së drejtës së pronës.

74. Për sa më sipër, vendimet e gjykatave të posaçme nuk janë arsytuar në mënyrë të mjaftueshme sa i takon respektimit të kriterëve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të pronës private, konkretisht në drejtëm të përshtatshmërinë dhe ashpërsisë së ndërhyrjes. Kjo mangësi në arsyetimin e këtyre gjykatave nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë.

75. Në përfundim, sipas këtij qëndrimi, mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sekuestros për ekuivalencë dhe mënyra se si kanë zbatuar parashikimet e nenit 36 të KP-së, pa dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për përshtatshmërinë dhe ashpërsinë e ndërhyrjes, ka sjellë një rezultat arbitrar në të drejtën kushtetuese të pronës private, duke i bërë këto vendime të papajtueshme me Kushtetutën. Për rrjedhojë, kërkesa duhej pranuar pjesërisht dhe Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit të GJKKO-së së Apelit, vetëm për sa i përket disponimit për sekuestron e vendosur mbi shoqërinë “Restur”, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë “Mediterranean Investment Group”, të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, që përbëjnë, sipas tyre, vlerën ekuivalente të asaj që dyshohet se është përfutur nga veprat penale, duke ia dërguar këtë pjesë të çështjes për shqyrtim GJKKO-së së Apelit, e cila, si gjykatë fakti dhe ligji, mund të korrigjonte shkeljen e konstatuar që lidhet me pamjaftueshmërinë e arsyetimit për elemente që kërkojnë vlerësim të faktit dhe të ligjit, duke u kujdesur që të arsyetonte për sa më sipër, për të garantuar një proces të rregullt gjyqësor në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për pronë private.

76. Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural të saj është i pabazuar, sepse gjykatat kanë arsytuar mjaftueshëm në lidhje me nevojën e vendosjes së sekuestros preventive me ekuivalencë.²

77. Sipas këtij qëndrimi, neni 36, pika 1, shkronja “ç”, i KP-së dhe neni 274, pika 2, i KPP-së lejojnë shprehimisht sekuestrimin e çdo pasurie tjetër (*pasuri ekuivalente*), vlera e së cilave i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Nuk është e paarsyeshme vendimmarrja e gjykatave që për sa kohë që në fazën fillestare të hetimit, nuk mund të përcaktoheshin ende me siguri përmasat e “produkteve të veprave penale”, si dhe pasuritë në fjalë lidheshin drejtpërdrejt me personin nën hetim Redi Molla, ato të mund të bëheshin objekt i sekuestros preventive. Sipas nenit 41, pika 3, të Kushtetutës, kufizimi mbi të drejtën e pronës për sa i përket shoqërisë “Restur”, tek e cila kishte interesa ekonomike kërkuesi tjetër Redi Molla (njëkohësisht i pandehur), përbën kufizim me ligj i ushtrimit të së drejtës së pronës, që synon të mbrojë interesin publik, të garantimit të mundësisë së konfiskimit eventual të produkteve të veprës penale ose vlerës ekuivalente të tyre. Ky interes publik në fazën fillestare të vendosjes së sekuestros, mbizotëron mbi interesat private që lidhen me mbrojtjen e pronësisë së shoqërisë “Restur”, për sa u përket pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë “Mediterranean Investment Group”. Sipas nenit 274, pika 3, të KPP-së, sekuestroja preventive mund të hiqet në çdo kohë kur ndryshojnë kushtet e zbatimit. Në rastin e pasurive ekuivalente, nëse gjenden pasuri që identifikohen si produkte të veprës penale, sekuestroja mund të vihet mbi to dhe të hiqet nga pasuritë ekuivalente të sekuestruara, kur vlerësohet se mbajtja e tyre në sekuestro nuk plotëson nevojat e parashikuara nga neni 36 i KP-së. Porse, në fazën fillestare të hetimit, veprimet e Prokurorisë së Posaçme dhe të gjykatave të zakonshme, nuk janë arbitrare, por kanë kryer një kufizim të përkohshëm të tagrave të pronësisë, që synon mbrojtjen e interesit publik dhe që nuk është joproporcional për sa i përket masës së marrë dhe interesit që synohet të mbrohet.

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Marjana Semini dhe Asim Vokshi.
Faqe | 12082



78. Pretendimi i kërkuesve në lidhje me modalitetet e vendosjes së sekuestros preventive, e cila, sipas tyre, duhej të realizohej përmes vendosjes së shënimeve në regjistrat publikë për ndalimin e tjetërsimit, gjë e cila, sipas tyre, do të ishte më pak kufizuese, nuk gjen mbështetje në ligj dhe për më tepër nuk mbështet ndonjë argument me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Edhe pse në vendimet gjyqësore objekt gjykimi mungon një analizë në lidhje me nënkriterin e ashpërsisë së masës në raport me të tre tagrat e së drejtës së pronës, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete dhe referuar qëllimit e pasojave të masës së sekuestros preventive, sikundër ato janë pranuar nga gjykatat e zakonshme, vlerësohet se masa në rastin konkret nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë. Sekuestroja preventive në dallim nga sekuestroja konservative (e cila zbatohet nga përmbartuesi sipas rregullave të KPC-së), administrohet sipas ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar. Kjo do të thotë se sipas nenit 4, shkronja “c”, e vijues të ligjit, ekzekutimi i sekuestros preventive bëhet sipas ligjit të posaçëm që parashikon edhe marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara, duke mos u mjaftuar vetëm te bërja e shënimeve në regjistrat publikë për sekuestron e sendeve të regjistrueshme në regjistra publikë. Në këtë kuptim, edhe pse kufizimi ka prekur të gjitha tagrat e pronësisë, konsiderohet se midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së pronës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë dhe është bërë në zbatim të rregullave të parashikuara në ligj, që synojnë të mbrojnë interesin publik. Në këtë situatë reale dhe faktike, masa e kundërshtuar, e cila ka kufizuar jo vetëm tagrin e disponimit, por edhe atë të gëzimit, konsiderohet se është proporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj.

79. Për sa më sipër, duhet mbajtur në konsideratë edhe hapësira e gjerë e vlerësimit të autoriteteve në ndjekjen e politikave penale në luftën kundër kriminalitetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për vepra të tilla penale të rënda, që prekin drejtpërdrejt interesin publik. Veprat penale konkrete i kundërdrejtohen autoritetit të shtetit, pasi kanë të bëjnë me veprime të punonjësve shtetërorë, që në vend që të ushtrojnë shërbimin publik, kryejnë veprime për të dëmtuar veprimtarinë shtetërore për qëllime të përfitimit personal. Për këtë arsye,

vlerësohet se procedurat, në tërësinë e tyre, kanë respektuar ekuilibrin e drejtë të kërkuar. Po kështu, vërehet se kërkuesve u është dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre përpara gjykatave të zakonshme dhe ata kanë pasur akses në dy nivele juridiksioni, ndërsa janë përfaqësuar nga avokat i zgjedhur prej tyre. Në këtë mënyrë, kërkuesve u është dhënë mundësia për të paraqitur çështjen e tyre në procedura kontradiktore përpara gjykatave të zakonshme, të cilat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për caktimin e masës së kundërshtuar, arsyetim ky që nuk duket të jetë arbitrar ose të mos plotësojë kërkesat e një gjykimi të drejtë. Ndaj edhe kjo pjesë e kërkimeve nuk duhej pranuar nga Gjykata, e cila, siç ka theksuar në jurisprudencën e saj konstante, nuk është shkallë e katërt e gjyqësorit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), por mbikëqyr vetëm kushtetutshmërinë e veprimtarisë gjyqësore, e cila, në rastin konkret, nuk rezulton të ketë cenuar parametrat kushtetues.

80. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuesve konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 133, pika 2, shkronja “I”, dhe 134, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.4.2026.

Shpallur më 17.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Asim Vokshi, Marjana Semini



VENDIM
Nr. 53, datë 28.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Farijsa Idrizaj, në datën 21.4.2026,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 21 (E) 2025 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ermal Kurtulaj, përfaqësuar nga
avokati Ermir Beta, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe
Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorja
Elida Kaçkini, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 65, datë
3.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë
për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 73,
datë 6.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së
Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr.
32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, të Gjykatës së
Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e
Organizuar; nr. 00-2025-20 (1), datë 14.1.2025, të
Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të
papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, pika 2, 42 dhe
131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6
të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
(*KEDN*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori
në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit

Ermal Kurtulaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin
e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar,
Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe
Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka
kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen
në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi nga viti 2022 ka qenë i ngarkuar me
detyrën e koordinatorit të zyrës *Facility Point* të
projektit EUSAIR pranë Agjencisë Shtetërore të
Programimit Strategjik dhe Koordinimit të
Ndihmës (*SASPAC*) si lehtësues dhe mbështetës
për Koordinatorin Kombëtar. Në ushtrim të këtij
funksioni, kërkuesi ka pasur si detyrë të kryente
procedurat e prokurimit për llogari të projektit,
procedura këto që, në bashkëpunim edhe me
persona të tjerë, dyshohet se janë kryer kohë më pas
në mënyrë fiktive në raport me përcaktimin e
fituesit.

2. Lidhur me këto dyshime, kërkuesi dhe disa
persona të tjerë janë proceduar penalisht nga
Prokuroria e Posaçme në kuadër të procedimit penal
nr. 190, datë 6.9.2023, të regjistruar për veprat penale
“Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim me pasoja të
rënda, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në
tendera apo ankande publike”, të kryer në
bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i personave që
ushtrojnë funksione publike”, i kryer në
bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të
lartë shtetërorë”, i kryer në bashkëpunim,
“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë
funksione publike” dhe “Refuzimi për deklarimin,
mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i
pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur
dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka
detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara nga
nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 258, paragrafi 2 e 25,
244, 259, paragrafi 2 e 25, 260 e 25 dhe 257/a,
paragrafi 2, të Kodit Penal (*KP*). Ajo prokurori ka
regjistruar edhe emrat e autorëve të dyshuar të këtyre
veprave, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkuesit në
datën 26.12.2023, ndërsa ky i fundit është dyshuar si
autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 143,
paragrafët 2 dhe 3, 260 e 25, si edhe 258, paragrafi 2
e 25, të KP-së.



3. Objekt i hetimit të Prokurorisë së Posaçme janë veprimet e kryera nga kërkuesi dhe të bashkëpandehurit gjatë viteve 2022–2023, që lidhen me disa procedura prokurimi, të cilat dyshohet se janë fiktive, si dhe në kundërshtim me rregullat e aplikueshme për prokurimet me fonde të Bashkimit Evropian (BE), referuar nenit 5, shkronja “c”, të ligjit nr. 37/2015, *“Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para Anëtarësimit (IPA II)”*.

4. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar gjykatës caktimin ndaj personave nën hetim të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, ku për kërkuesin ka kërkuar masën “Arresti në burg”, si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 260 e 25, si edhe 258, paragrafi 2 e 25, të KP-së. Mbi këtë kërkesë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë), me vendimin nr. 65, datë 3.7.2024, ndër të tjera, ka vendosur caktimin ndaj kërkuesit të masës “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi është ekzekutuar në datën 4.7.2024 dhe, në vijim, në përputhje me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuesin e arrestuar, me qëllim verifikimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim, me vendimin nr. 73, datë 6.7.2024, ajo gjykatë, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për caktimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO-ja e Apelit), me vendimin nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së të Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, me vendimin 00-2025-20 (1), datë 14.1.2025, ndër të tjera, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, të GJKKO-së Apelit.

6. Në datën 25.7.2025, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 1.8.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 7.11.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

7.1.1 *Parimit të paanshmërisë*, pasi vendimi i GJKKO-së së Apelit, duke rënduar pozitën e të pandehurit, si dhe duke lënë në fuqi një masë sigurimi ekstreme, ka treguar njëanshmërinë e asaj gjykate në marrjen e vendimit.

7.1.2 *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimet e gjykatave të zakonshme janë në shkelje të nenit 245, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, duke qenë se nuk kanë arsyetuar se përse masat e tjera më të lehta të sigurimit ishin të papërshtatshme për të.

7.2 *Liria personale*, pasi shkeljet procedurale dhe kushtetuese të bëra nga gjykatat e zakonshme në procesin për caktimin/vleftësimin e masës së sigurisë së tij, janë të tilla që cenojnë parimet e një procesi të rregullt ligjor, për rrjedhojë edhe të drejtat kushtetuese të tij. Edhe në drejtim të ngritjes së akuzave konkrete, Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të ngrenë mjaftueshëm dyshimin e arsyeshëm se ai i kishte kryer veprat për të cilat dyshohej.

7.3 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka shtuar rrethana rënduese për të. Ajo gjykatë ka pasqyruar në vendim mendimin e saj se personat nën hetim ishin të fajshëm, ndonëse çështja ishte ende në hetim. Po ashtu, ky parim është shkelur edhe nga fakti se masat e sigurimit personal nuk janë dënime penale, por masa që lidhen me nevojat e sigurimit.

7.4 *Parimi i proporcionalitetit*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë marrë në analizë asnjë nga rrethanat e përcaktuara si detyruese nga vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr. 7, datë 14.10.2011 (*vendimi unifikues nr. 7/2011*), të tilla siç janë personaliteti, precedentët penalë, sjellja, mënyra e jetesës dhe rrethanat e tjera individuale, familjare e



sociale, duke qenë në kundërshtim në këtë mënyrë edhe me nenin 5 të KEDNJ-së. Gjithashtu, një masë më e lehtë sigurimi është e përshtatshme edhe për faktin se nuk ka asnjë rrezik për dëmtimin e provave, pasi ato tashmë janë administruar, ndërkohë që dijenia për këtë hetim e kërkuesit është që prej vitit 2023 dhe ai as është larguar, as ka tentuar të prishë provat në ndonjë rast. Po ashtu, gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar as se ku konsiston rreziku i largimit, në kushtet kur gjatë kohës që zhvilloheshin hetimet ai ka dalë disa herë jashtë shtetit. Gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të analizojnë dhe argumentojnë se rrezikshmëria e veprave penale dhe e vet të pandehurit janë të tilla që asnjë masë tjetër më e lehtë sigurimi, se ajo e arrestit në burg, nuk do të ishte e përshtatshme për kërkuesin. Në këto rrethana, ato gjykata duhej të kishin caktuar një masë më të lehtë sigurimi, të përshtatshme me nivelin e të dhënave lidhur me të.

7.5 *Parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka tejkualuar kompetencat duke shtuar një vepër tjetër penale që është “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i KP-së, ndërkohë që duhej të kufizohej në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të shkallës së parë, brenda shkaqeve të ankimit. Ajo gjykatë, duke shtuar një vepër tjetër penale, ka shtuar edhe një nevojë tjetër sigurimi, për rrjedhojë ka zbatuar një masë më të rëndë sigurimi se ajo që duhej dhënë, duke vepruar në rastin konkret në shkelje të nenit 425 të KPP-së.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

8.1 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit* nuk qëndron, për faktin se nga ana e të tria gjykatave të zakonshme është arsyetuar mjaftueshëm lidhur me caktimin e masës.

8.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë personale* nuk qëndron, pasi si nga gjykata që ka caktuar masën, ashtu edhe nga ato që e kanë kontrolluar atë, është respektuar kriteri i dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit.

8.3 Pretendimi që lidhet me *proporcionalitetin e masës* nuk qëndron, pasi, referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, masa është vendosur në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit, si dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal. Për sa i takon

rrezikut të dëmtimit të provave, sjellja e kërkuesit në datën 28.12.2023, e faktin plotësisht këtë rrethanë, pasi gjatë kontrollit të banesës nga oficerët e Policisë Gjyqësore, ai ka mundur të ndërhyjë në provat materiale, duke kthyer telefonin në gjendjen fillestare.

8.4 Pretendimet për shkelje të parimit të *prezumimit të pafajësisë* dhe atij të *mosrëndimit të pozitës të të pandehurit*, të ngritur nga kërkuesi, nuk qëndrojnë, pasi në rastin konkret apelues rezultoi edhe Prokurori i Posaçëm, ndaj dhe pretendimi i kërkuesit është i pabazuar si në jurisprudencën e Gjykatës, ashtu edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në bazën ligjore të vendimit të GJKKO-së së Apelit është vendosur pika 1 e nenit 425 të KPP-së, e cila kuadron kufijtë e shqyrtimit në gjykimin në apel për sa janë shkaqet në ankim, si edhe të drejtën e gjykatës për adresim të çështjeve të ligjit që mund të shqyrtohen kryesisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka



interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohej vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor.

12. Për sa u përket vendimeve të kundërshtuara për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, Gjykata vlerëson se edhe pse ato janë me natyrë të ndërmjetme, të dhëna në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Gjykata i ka konsideruar këto lloj vendimesh, në mënyrë përjashtimore, si përfundimtare për qëllime të gjykimit kushtetues, për sa kohë që ato sjellin kufizimin e lirisë personale të individit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për sa u takon pretendimeve të parashtruara për këto vendime, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit (gjykatat e posaçme dhe Gjykatën e Lartë) dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka *shteruar mjetet juridike efektive* në dispozicion.

13. Për legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, Gjykata evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 14.1.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë

më 25.7.2025. Nga ana e kërkuetit, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *email-i* i dërguar mbrojtësit të kërkuetit nga Gjykata e Lartë që i ka komunikuar vendimin e saj në datën 25.3.2025, çka provon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, e për pasojë kërkueti legjitimohet *ratione temporis*.

15. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkueti ka pretenduar cenimin e *lirisë personale*, për shkak të caktimit ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, *parimit të proporcionalitetit*, *parimit të mosrëndimit të pozitë të të pandehurit* dhe *prezumimit të pafajësisë*, ndërsa në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të paanshmërisë* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

16. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuetit lidhur me cenimin e *parimit të paanshmërisë* dhe ato për *parimin e prezumimit të pafajësisë* dhe *mosrëndimit të pozitë të të pandehurit*, pavarësisht mënyrës sesi janë ngritur nga kërkueti, në thelb, lidhen me argumentin e tij se GJKKO-ja e Apelit, duke shtuar një vepër tjetër penale, që është “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i KP-së, ka rënduar pozitën e kërkuetit në tejkalim të kompetencave të saj.

17. GJKKO-ja e Apelit, në vendimin e saj, ka vlerësuar se përveç dyshimit të arsyeshëm për konsumimin e veprës penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim ndërmjet kërkuetit dhe të bashkëpandehurit I. B., të parashikuar nga nenet 258, paragrafi 2, dhe 25 të KP-së, në këtë rast dyshohet edhe për konsumimin e elementeve të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 186, paragrafi 3, dhe 25 të KP-së. Kjo vepër e fundit, ka arsyetuar ajo gjykatë, dyshohet se është kryer në bashkëpunim nga kërkueti, i cili ka përgatitur aktet në cilësinë e koordinatorit pranë SASPAC-ut, duke pasqyruar fakte të pavërteta lidhur me kohën e zhvillimit të tyre, komunikimin e tyre subjekteve pjesëmarrëse në procedurë, si dhe nënshkrimin në emër të tyre të ofertave.

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij, për këtë pretendim të kërkuetit ka vlerësuar se me të drejtë ajo gjykatë ka argumentuar se pavarësia e organit të akuzës jep garanci të mjaftueshme lidhur me dhënien e një cilësimi juridik të pavarur faktit penal për të cilin procedohet në



momentin e dërgimit të çështjes për gjykim, ndërkohë që është detyrë e gjykatës dhe shprehje e pavarësisë së saj që të përcaktojë saktë veprën e kryer nga i dyshuari, për faktin se masa e sigurimit personal duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me rëndësinë e faktit penal dhe në konformitet me kriterin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 229 të KPP-së. Përndryshe, ajo gjykatë do të gabonte në caktimin e masës, nëse nuk i jep faktit një cilësim juridik të drejtë. GJKKO-ja e Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, por ka vlerësuar në mënyrë autonome rëndësinë e fakteve konform natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohet. Arsyetimi i gjykatës në drejtim të nevojave të sigurimit personal nuk përbën rëndim të pozitës të të pandehurit, pasi është organi i akuzës ai që vlerëson gjatë hetimit paraprak se për cilat vepra penale do të ngrejë përfundimisht akuzë.

19. Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shtimin nga ana e GJKKO-së së Apelit të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim. Gjykata ka pohuar se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale të cilat kryhen nga organi procedues (prokurori ose gjykata), pasi individit merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njofimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se për sa kohë që gjykatat e zakonshme nuk kanë zgjeruar faktin penal të paraqitur nga prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, është e qartë që vlerësimi i tyre për ekzistencën e elementeve të një veprë të caktuar penale, të ndryshme nga ajo e paraqitur nga prokurori, për faktin e paraqitur nga ai, nuk përbën ngritje të një akuze të re nga gjykata, por vlerësim të gjykatës të nevojave të sigurimit, që kërkon, ndër të tjera, analizimin në mënyrë konkrete të rëndësisë së faktit penal (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se GJKKO-ja e Apelit, në thelb, nuk e ka zgjeruar faktin penal, duke mos e rënduar pozitën e kërkuesit, gjatë shqyrtimit të masës së sigurimit, që nuk është një proces themeli, prandaj ky pretendim është haptazi i papabuar.

20. Lidhur me pretendimet e tjera të kërkuesit, Gjykata evidenton se në jurisprudencën e saj ka pohuar se liria personale ka dy anë: atë substanciale,

që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedurale, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, duke vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *lirisë personale* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, bazuar edhe në arsyetimin e gjykatave të zakonshme, Gjykata në vijim do ta analizojë atë në aspektin substancial në drejtim të: i. standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova; dhe ii. parimit të proporcionalitetit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale

B.1.1 Në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova

22. Kërkuesi ka pretenduar se Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë mjaftueshëm lidhur me dyshimin e arsyeshëm se ai i kishte kryer veprat për të cilat dyshohej.

23. Subjekti i interesuar ka prapësuar se nga ana e të tria gjykatave të zakonshme është respektuar e drejta e kërkuesit për pasjen e një vendimi të arsyetuar, ndër të tjera, edhe për sa i takon dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova.

24. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale (paragrafi 2, shkronja “c”).

25. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të



informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një vepër penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individ, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata do të analizojë faktin nëse gjykatat e zakonshme, nëpërmjet arsyetimit të vendimit, kanë respektuar kriterin kushtetues të dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit.

29. Gjykata vëren se kërkuesi është proceduar penalisht dhe i është nënshtruar masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, për shkak se ai, në cilësinë e koordinatorit pranë SASPAC-ut, gjatë viteve 2022–2023, dyshohet se ka vepruar në kundërshtim me rregullat e aplikueshme për prokurimet me fonde të BE-së, si dhe për fiktivitetin e disa procedurave dhe kontratave respektive. Në këto rrethana, kërkuesi është dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shkelja e barazisë së

pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” dhe “Mashtrimi”.

30. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në të dyja vendimet e saj, atë lidhur me caktimin e masës së sigurimit e më tej atë të marrjes në pyetje të kërkuesit, ka arsyetuar se, referuar provave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme, ekzistojnë të dhëna që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi ka kryer dy nga tri veprat penale për të cilat dyshohet. Në lidhje me kushtin e dyshimit të arsyeshëm, ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se për caktimin nga ajo të masës së sigurimit, dyshimi bazohej në analizën e veprimtarisë të kërkuesit në lidhje me shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Ajo gjykatë ka konsideruar se kishte dyshime të arsyeshme, lidhur me kualifikimin e bërë nga Prokuroria e Posaçme, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, si edhe 258, paragrafi 2 e 25, të KP-së.

31. Konkretisht, ajo gjykatë, për veprën penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i KP-së, ka marrë në analizë tetë kontrata prokurimi, me vlerë totale rreth 287.200 euro, me subjekte të ndryshme tregtare, të cilat lidhen me eventin “FESTA”, objekt i hetimit, për të cilat rezultojnë të dhëna të mjaftueshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm për paracaktimin e fituesve dhe fiktivitetin e dokumentacionit justifikues që është sekuestruar dhe paraqitur si provë dhe që konsiston në: i. rënien dakord për kryerjen e shërbimit; ii. ftesat dërguar subjekteve; iii. urdhrat e ngritjes së komisioneve për vlerësimin e ofertave; iv. njoftimin e fituesve; v. lidhjen e kontratave; vi. autorizimin e pagesave. Për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i KP-së, ajo gjykatë, pasi ka vlerësuar provat e paraqitura, ka arritur në konkluzionin se kontrata me shoqërinë “L. I.”, shërbimet dhe pagesat, është fiktive, sepse pjesa dërrmuese e shërbimeve të marra përsipër me atë kontratë janë kryer nga shoqëria për shkak të një marrëdhënieje tjetër kontraktore. Këto dyshime janë ngritur mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, bisedave telefonike dhe dëshmisë së shtetas H. D. Gjithashtu, nga gjykata janë marrë në analizë edhe procedura të tjera tenderimi, si ajo me shoqëritë “B. C.” dhe “N. S.”, si dhe ajo me të bashkëpandehurin B. L., të cilat kanë rezultuar fiktive, e provuar kjo nga dokumentacioni i



sekuestruar edhe nga komunikimet telefonike të kërkuesit dhe personave të tjerë të përfshirë.

32. Në vijim, masa e sigurimit ndaj kërkuesit i është nënshtruar kontrollit nga GJKKO-ja e Apelit, e cila, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë i ka konsideruar të bazuara vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë dhe pasi i ka rimarrë në analizë episodet e evidentuara nga Prokuroria e Posaçme dhe provat e paraqitura nga ajo, ka konkluduar se nga tërësia e tyre ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen nga kërkuesi, në bashkëpunim, të veprës penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”. Për veprën penale “Mashtrimi”, për të cilën dyshohet kërkuesi, ajo gjykatë ka theksuar se e gjente të drejtë konstatimin e Prokurorisë së Posaçme dhe qëndrimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Për sa i takon episodit kriminal për kontratën me shoqërinë “L. I.”, ajo gjykatë ka konstatuar se për këtë rast kjo veprë ka një element cilësues që konsiston në pasojën e rëndë të ardhur, vlerën e kontratës në shumën rreth 125.000 euro, duke u kualifikuar sakaq në paragrafin e tretë të nenit 143 të KP-së. Nga ajo gjykatë janë analizuar të dhënat që rezultojnë nga komunikimet telefonike dhe të dhënat nga këqyrja e kompjuterëve, dokumenteve shkresore dhe shënimeve të gjetura nga kontrolli i zyrës dhe banesës së kërkuesit, si dhe praktikave të pagesave. Gjithashtu, GJKKO-ja e Apelit i ka kthyer përgjigje të arsyetuar edhe pretendimeve të ngritura në ankim nga ana e kërkuesit.

33. Çështja është shqyrtuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, i cili ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë disponuar drejt lidhur me caktimin e masës së sigurisë, duke u dhënë përgjigje të argumentuara dhe ezauruese të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Ai kolegji ka vlerësuar se lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, për veprat penale për të cilat kërkuesi dyshohej, gjykatat e faktit kanë verifikuar mjaftueshëm e më tej kanë arsyetuar ekzistencën e provave, rrethanave të faktit dhe elementeve të mjaftueshme juridike që provonin se kërkuesi mund t'i kishte kryer ato. Sipas saj, GJKKO-ja e Apelit e ka plotësuar vendimarrjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë me një analizë cilësore të provave të marra deri në atë fazë të procedimit penal.

34. Gjykata vlerëson se GJKKO-të e faktit dhe Gjykata e Lartë, në caktimin e masës së sigurimit

personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, me të drejtë kanë vlerësuar se ekzistonin kushtet për vendosjen e saj, në fazat fillestare të hetimit, si pasojë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm. Gjithashtu, të tria gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm për faktet që kanë shërbyer si bazë për caktimin e masës së sigurimit personal.

35. Në këndvështrim të sa më lart dhe duke mbajtur parasysh standardet e sipërpërmendura, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë së tij personale, pasi është bazuar në fakte dhe informacione, të cilat u kanë krijuar bindjen gjykatave të zakonshme se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilat ai dyshohet.

36. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit duket se ka informacione që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova janë të pabazuara.

B.1.2 Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

37. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të proporcionalitetit, duke parashtruar se gjykatat e faktit nuk kanë marrë në analizë asnjë nga rrethanat e përcaktuara si detyruese nga vendimi unifikues nr. 7/2011, të tilla si personaliteti, precedentët penalë, sjellja, mënyra e jetesës dhe rrethanat e tjera individuale, familjare e sociale, duke qenë në kundërshtim në këtë mënyrë edhe me nenin 5 të KEDNJ-së. Gjithashtu, një masë më e lehtë sigurimi është e përshtatshme edhe për faktin se nuk ka asnjë rrezik për dëmtimin e provave, pasi ato tashmë janë administruar, ndërkohë që dijenia për këtë hetim e kërkuesit është që prej vitit 2023 dhe ai as është larguar, as ka tentuar të prishë provat në ndonjë rast. Po ashtu, gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar as se ku konsiston rreziku i largimit, në kushtet kur gjatë



kohës që zhvilloheshin hetimet ai ka dalë disa herë jashtë shtetit.

38. Subjekti i interesuar, për pretendimin që lidhet me proporcionalitetin e masës, ka prapësuar se ai nuk qëndron, pasi, referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, masa është vendosur në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit, si dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal. Për sa i takon rrezikut të dëmtimit të provave, sjellja e kërkuesit në datën 28.12.2023, e fакton plotësisht këtë rrethanë, pasi gjatë kontrollit të banesës nga oficerët e Policisë Gjyqësore, ai ka mundur të ndërhyjë në provat materiale, duke e kthyer telefonin në gjendjen fillestare.

39. Gjykata në jurisprudencën e saj në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal në drejtim të proporcionalitetit ka pohuar se ajo duhet të jetë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur dhe se arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë duhet të jenë “relevante dhe të mjaftueshme”. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë që ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Gjithashtu, në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata bazohet në arsyetimin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se u takon atyre që, përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Ndërkohë, KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (shkronja “a”); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (shkronja “b”); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (shkronja “c”). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit

personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit (pika 1).

41. Për sa më lart, si dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata vlerëson të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, për rrezikun që i pandehuri të largohet, si dhe për rrezikun që për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit kërkuesi të kryejë krime të tjera. Për këtë qëllim, Gjykata do të mbajë në konsideratë kontekstin e fakteve të çështjes për të përcaktuar nëse masa e caktuar ndaj kërkuesit është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur, si dhe nëse çdo masë tjetër është e papërshtatshme.

42. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, pa rënë në përsëritje të fakteve, Gjykata çmon të evidentojë në vijim arsyet e veçanta që gjykatat e zakonshme parashtruan për justifikimin e paraburgimit të kërkuesit për sa u përket argumenteve të tyre rreth përshtatshmërisë së kësaj mase.

43. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi ka argumentuar se plotësohen të dyja kushtet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 228 të KPP-së, ka marrë në analizë kushtet e veçanta të përcaktuara në pikën 3 të të njëjtit nen, në përputhje edhe me qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 7/2011. Konkretisht, ajo gjykatë ka marrë, *së pari*, në shqyrtim ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, *së dyti*, rrezikun e largimit dhe, *së treti*, rrezikun që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të njëjta me atë për të cilin procedohet.

44. Lidhur me ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose



vërtetësinë e provave, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet kur nuk ishte përfunduar marrja e provave nga ana e organit të akuzës, ekzistonte mundësia që të pandehurit, përfshirë kërkuesin (për shkak të rolit të tij), të ndiknin negativisht në këtë proces. Për sa i takon rrezikut të largimit, ajo gjykatë ka arsyetuar se në rastin e kërkuesit ky rrezik rezultonte prezent dhe tepër serioz në raport me veprat penale për të cilat procedohej dhe rrezikshmërinë e tyre, rolin e tij qendror dhe organizator, pasojat, si dhe shtrirjen në kohë të këtyre veprave. Duke marrë në analizë elementin e tretë, që lidhet me rrezikun që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të njëjta me atë për të cilin procedohet, ajo gjykatë ka argumentuar se ai rrezik është prezent në kushtet kur kërkuesi ka një rol të rëndësishëm dhe i ka kryer veprat penale disa herë e të shtrira në kohë, duke dëshmuar qëndrueshmëri në raport me qëllimet e tij të kundërligjshme, si dhe duke dëshmuar një raport të dobët të tij në raport me ligjin.

45. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në vijim, ka arsyetuar se në caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin përmbusheshin kriteret e përcaktuara në nenet 229 dhe 230 të KPP-së. Konkretisht, referuar pikës 1 të nenit 229 të KPP-së, shkalla e nevojave të sigurimit rezultonte e lartë referuar rrezikshmërisë së veprave për të cilat dyshohej, kryerjes së disa prej veprave disa herë, të shtrira në kohë dhe në prezencë të rrethanave rënduese, në abuzim me funksionin publik, duke dëshmuar prezencën e një mendimi të konsoliduar, raportin e dobët të kërkuesit në respektimin e ligjit, si dhe rolin e tij si ideator. Po ashtu, ajo gjykatë në caktimin e masës ka mbajtur parasysh edhe masën e dënimit për veprat penale për të cilat kërkuesi dyshohej, kryerjen më shumë se një herë të veprave penale, si dhe prezencën e të tria kushteve të veçanta alternative të parashikuara nga neni 288, pika 3, i KPP-së. Në përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se nga analiza e kryer rezultoi se masa e caktuar “Arresti në burg” është e përshtatshme dhe se nuk rezultoi të jetë e pranishme ndonjë nga rrethanat të cilat nuk lejojnë caktimin e kësaj lloji mase.

46. Në vijim, Gjykata konstaton se në vendimin për vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, pasi ka dëgjuar pretendimet e kërkuesit, ka arritur në përfundimin se nuk rezultonte asnjë rrethanë e ndryshme në lidhje me arsyet e veçanta për justifikimin e paraburgimit, në kuptim të nenit 228,

pika 3, të KPP-së, duke konfirmuar me të njëjtat argumente qëndrimin e mbajtur në rastin e caktimit të masës.

47. GJKKO-ja e Apelit ka analizuar masën e sigurimit që duhej të caktohej në raport me rrethanat e çështjes. Për sa u takon nevojave të sigurimit, në analizë të kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, ajo gjykatë, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se për kërkuesin ekzistonte vetëm rreziku i largimit, i lidhur me veprat penale të cilat i atribuohen atij, rrezikshmërinë që ato paraqesin, kryerjen e tyre të shtrira në kohë, rolin qendror dhe organizator të tij në realizimin e fakteve penale objekt procedimi, pasojat e veprës dhe masës së sanksionit që parashikojnë. GJKKO-ja e Apelit, në ndryshim nga ajo e shkallës së parë, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave ka vlerësuar se nuk është arritur të provohet se cilat prova mund të dëmtoheshin në kushtet kur kërkuesi nuk kryente më detyrën publike dhe as të provohet rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale. Në përfundim, ajo gjykatë ka analizuar masën e sigurimit që duhet të caktohej (vijohej të zbatohet) në raport me rrethanat e çështjes, duke konsideruar atë si proporcionale dhe çdo masë tjetër më të lehtë sigurimi si të papërshtatshme.

48. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, ka konfirmuar kushtet e veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal, duke konkluduar për këtë pjesë ndryshe nga gjykata e apelit, e cila vlerëson se ekziston vetëm rreziku i ikjes për kërkuesin, se ekzistojnë të tria këto kushte, pra përveç rrezikut të ikjes edhe rreziku për helmimin e provave, si dhe, megjithëse në masë të vogël, ai për të kryer vepra të tjera penale. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konfirmuar se përmbushet edhe përshtatshmëria, si dhe proporcionaliteti i masës në raport me rrethanat e faktit, rolin dhe pozitën e personit nën hetim, si dhe në raport me nevojat e sigurimit. Kolegji Penal ka konkluduar se në rastin konkret nuk është provuar nevoja e caktimit të një mase sigurimi personal më të butë nga ajo në fuqi.

49. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në vendimet e tyre përfundimisht gjykatat e zakonshme nuk e kanë justifikuar vazhdimin e paraburgimit të kërkuesit vetëm me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprat penale, por kanë dhënë edhe arsye të tjera të veçanta, të tilla si rreziku



i marrjes dhe manipulimit të provave, rreziku i largimit, rreziku i arratisjes së kërkuesit, si dhe, megjithëse i vogël, rreziku që kërkuesi të kryente vepra të tjera penale, arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e vazhdimin të paraburgimit të një individi. Arsyetimi i tyre në këtë drejtim nuk është abstrakt. Duket se gjykatat e zakonshme kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë në këtë rast të atyre rreziqeve, duke evidentuar kompleksitetin e hetimit, në pikëpamje të shtrirjes në kohë të veprimtarisë së dyshuar si kriminale, bashkëpunimin, rolin e tij në kryerjen e veprave penale, por edhe ndikimin potencial negativ që ai mund të kishte në vijimin e hetimeve.

50. Gjykata vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet, duke detajuar në arsyetimin e tyre rrethanat që kanë vlerësuar për efekt të caktimit të masës më të rëndë të sigurimit me karakter shtrëngues. Gjithashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë iu referua nevojës për të përfunduar hetimin si shkak për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, duke specifikuar provat që duhej të mblidheshin ende, të cilat konsistonin në vërtetimin e raporteve mes kërkuesit dhe subjekteve përfituese të shumave monetare. Vendimet e gjykatave të faktit janë lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili i ka konsideruar të drejta argumentet e dhëna nga ato gjykata, si dhe ka arsyetuar gjetjet në drejtim të të drejtave procedurale e kushtetuese të kërkuesit. Të tria gjykatat e zakonshme kanë analizuar edhe në drejtim të kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së.

51. Për sa i përket rrezikut të largimit për t'u shmangur procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, në mënyrë të arsyeshme, i janë referuar natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohej, rëndësisë së faktit, sanksionit për veprat penale, natyrës dhe shkallës së pasojave të ardhura prej tyre, çka në raport edhe me sjelljen e shfaqur nga ai në vijimësi, si dhe në raport me përmbushjen e detyrimeve ligjore në ushtrimin e funksioneve ose shërbimeve me karakter publik, pra prirjen e tij për të mos iu

bindur ligjit, tregojnë për mundësinë e largimit të tij nëse do të ishte i lirë.

52. Gjykata çmon në vijim se gjykatat e zakonshme kanë parashtruar mjaftueshëm argumente edhe në drejtim të përshtatshmërisë së masës së paraburgimit të kërkuesit dhe përfundimi i tyre se çdo masë tjetër nuk është e përshtatshme nuk duket i paarsyeshëm në raport me nevojat e sigurimit që janë evidentuar në rastin konkret.

53. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se masa e sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit duket se është justifikuar mbi tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë së tij, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, për qëllime të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata çmon se masa e sigurimit personal “Arresti në burg” nuk është në raport të zhdrejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe rezulton në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal për të cilin ai dyshohet, si dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së.

54. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, janë të pabazuara, për sa kohë që masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, dhe ajo nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me veprat penale për të cilat ai dyshohet, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj.

55. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.4.2026.

Shpallur më 16.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi

VENDIM

Nr. 3, datë 25.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	kryetar;
Natasha Mulaj	anëtare;
Ina Rama	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Albana Shtylla	anëtare,

- mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në datën 25.5.2026, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 3/2025, datë 3.11.2025, që i përket:

ANKUESE: Ajshe Xhafa, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin

e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

BAZA LIGJORE: Neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 147, pika 1 e Kushtetutës; neni 147/d i Kushtetutës; neni 179, pika 7 e Kushtetutës; neni 100, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016; neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016; neni 105, pika 1, e ligjit nr. 96/2016; neni 107, i ligjit nr. 96/2016; neni 115, i ligjit nr. 96/2016; neni 138, i ligjit nr. 96/2016; neni 146, i ligjit nr. 96/2016; neni 147, i ligjit nr. 96/2016; neni 148, i ligjit nr. 96/2016; neni 149, i ligjit nr. 96/2016; neni 86, i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; neni 97, i ligjit nr. 115/2016; neni 98, i ligjit nr. 115/2016; neni 100, i ligjit nr. 115/2016; neni 4, i ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; neni 5, i ligjit nr. 98/2016.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankueses Ajshe Xhafa, e cila ka kërkuar pranimin e ankimit, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që kanë kërkuar rrëzimin e ankimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankuesja Ajshe Xhafa (në vijim “ankuesja” dhe/ose “magjistratja”) ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, e caktuar në këtë pozicion me vendimin nr. 631, datë 19.10.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Në referim të shpjegimeve dhe të akteve në dosje, ankuesja ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale me nr. {***}. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”, për të cilën, pasi është zhvilluar një



seancë gjyqësore³, në seancën e radhës⁴ është paraqitur kërkesa për gjykim të shkurtuar dhe, si rrjedhim, kjo seancë është shtyrë me qëllim formimin e trupit gjykues, i cili është formuar me kryesuese gjyqtaren E. F. dhe anëtarë gjyqtaret Ajshe Xhafa dhe S. K.⁵, të cilat kanë marrë dijeni se seanca e radhës do të zhvillohej në datën 11.9.2024.

3. Në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, anëtarja e trupit gjykues, magjistratja Ajshe Xhafa, përveç kërkesës për shtyrje të seancës, me arsyen se nuk është njohur me aktet e dosjes, duke kërkuar kohë për t'u njohur dhe për t'u shprehur, në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar, ka relatuar, ndër të tjera⁶, si vijon.

“3.1 [...] është hera e dytë që qoftë gjyqtare S. K. dhe kryesuesja e trupit gjykues nuk më vënë në dispozicion dhe krijojnë pengesa në lidhje me studimin e dosjeve, përkatësisht e njëjta situatë ka qenë në çështjen penale me të pandehur E. M., e njëjta situatë edhe me këtë çështje penale, unë nuk jam njohur me dosjen, nuk e ka pasur asnjëherë dosjen dhe, për këto arsye, për t'u shprehur lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar kërkoj kohën e mjaftueshme[...].”

3.2 [...] Më duket totalisht e pavend dhe e papranueshme që dhe në seancën e kaluar në një çështje penale me ju të dyja anëtare të trupit gjykues, kërkonti dhe nxirrni pengesa të tilla ndaj meje si anëtare e trupit gjykues, kjo bëhet nga të dyja gjyqtaret S. K. dhe E. F., dhe kjo është bërë edhe në këtë seancë gjyqësore dhe unë mendoj që pretendime dhe sjellje të tilla të të dyjave anëtareve të trupit gjykues janë në mënyrë tendencioze dhe të qëllimshme për të më penguar mua si anëtare e trupit gjykues, për të pasur kohën e nevojshme për t'u njohur me dosjen në fjalë [...].”

3.3 Pas fjalës së kryetares së trupit gjykues⁷, magjistratja Ajshe Xhafa ka vijuar me relatimin në seancë gjyqësore: “Pretendime të tilla, siç edhe kryetarja e trupit gjykues i konstatoi, janë të pabazuara dhe janë të

pa pranueshme për t'u zhvilluar në një seancë gjyqësore, nisur me sa u relatua nga ana e kryesueses së trupit gjykues. Në lidhje me procesverbalet, unë çmoj se duke qenë se kjo është çështje e cila po përsëritet, është përsëritur edhe në çështjen penale E. M., për të cilën të paktën nga disa palë pjesëmarrëse në proces është njoftuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili është duke inspektuar dosjen dhe do të inspektojë dosjet, unë çmoj si anëtare e trupit gjykues, duke qenë se nga ana e të dyjave anëtareve kjo është një situatë e cila ka filluar të bëhet e vazhdueshme, duke mos u vënë dosjet dhe fashikujt e prokurorisë në dispozicion në mënyrë të qëllimshme nga ana e të dyjave anëtarëve të trupit gjykues të njoftohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me sjelljet e të dyja anëtareve [...].”

4. Seanca gjyqësore, në të cilën kanë qenë prezent përfaqësuesi i organit të akuzës dhe avokati mbrojtës është shtyrë për t'u zhvilluar në një datë tjetër, për dhënien e kohës gjyqtare Ajshe Xhafa të njihet me aktet e dosjes dhe, po atë ditë, kryesuesja e trupit gjykues, gjyqtarja E. F. ka kërkuar të diskutohet sjellja e gjyqtare Ajshe Xhafa në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve.

5. Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.9.2024⁸, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, procesverbalin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të datës 11.9.2024, në të cilin është diskutuar shqetësimi i ngritur nga gjyqtarja E. F., në lidhje me sjelljen e magjistrates Ajshe Xhafa gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore⁹. Të njëjtin shqetësim ka ngritur edhe gjyqtarja S. K., e cila ka parashtruar se magjistratja Ajshe Xhafa ka pasur të njëjtën sjellje edhe me të, duke pretenduar fshehjen e fashikujve hetimorë në një çështje tjetër penale¹⁰.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”),

kërkon t'i vihet në dispozicion, çmoj të bazuar kërkesën për t'ia vënë në dispozicion aktet në origjinal gjyqtare, për t'u njohur, t'i japë edhe kohën e mjaftueshme për t'u njohur dhe për t'u shprehur lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe nuk ka nevojë të vijojë debati në proces, pasi palët nuk interesohen për zgjidhjen e kësaj pjese administrative, interesohen për zgjidhjen e çështjes së tyre në themel).

⁸ Sipas raportit nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së “Për betimin disiplinor me iniciativë, ndaj veprimtarisë së magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.

⁹ Çështja penale me nr. {***}, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”.

¹⁰ Çështja penale me nr. {***}, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”.



me vendimin nr. 2448/2, datë 15.10.2024, ka vendosur fillimin e hetimit me iniciativë ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronja “dh” dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. ILD-ja, me vendimin nr. 2448/32 prot., datë 14.2.2025, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, ka vendosur: “1. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates S. K. dhe Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronjat “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

[...] 3. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkelje disiplinore nga neni 102, pika 2, shkronja “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Propozimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b” dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronja “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. [...]”.

8. Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.2.2025, ILD-ja i ka njoftuar magjistrates Ajshe Xhafa vendimin nr. 2448/32 prot., datë 14.2.2025, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, si dhe raportin e hetimit disiplinor nr. {***} prot., datë 13.2.2025.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka administruar shkresën e ILD-së me nr. {***} prot., datë 14.2.2025, me anë të së cilës është paraqitur kërkesa “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, me

propozimin për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b” dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), shoqëruar me raportin për hetimin disiplinor nr. {***} prot., datë 13.2.2025, dhe dosjen hetimore për zhvillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të kësaj magjistrateje.

10. Magjistratja Ajshe Xhafa dhe ILD-ja janë vënë në dijeni me shkresën e KLGj-së nr. {***} prot., datë 4.3.2025, për vendimin nr. 120, datë 27.2.2025, të KLGj-së “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, në datën 18.3.2025. Magjistratja Ajshe Xhafa ka depozituar në KLGj parashtrimet e saj me shkrim, lidhur me fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj në datën 17.3.2025.

11. KLGj-ja, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, me vendimin nr. 190, datë 2.4.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, vendim i cili i është komunikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 1.7.2025.

12. Kundër vendimit të mësipërm të KLGj-së, ka ushtruar ankim magjistratja Ajshe Xhafa, duke kërkuar: i. pranimin e ankimit; ii. shfuqizimin e vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; dhe iii. në mënyrë alternative, nëse do të konstatohet përgjegjësi disiplinore, të zëvendësohet masa me një masë më të lehtë, edukative (vërejtje konfidenciale), ose të kthehet çështja për rishqyrtim për arsyetim dhe individualizëm të masës.

13. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak për çështjen nr. 3/2025 të Juridiksionit Disiplinor (JD), me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, ka vlerësuar se ankimi plotëson të gjitha



kushtet për t'u gjykuar në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si një ankim individual ndaj masës disiplinore të dhënë, në referim të nenit 5, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 32, pika 1, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

14. Me vendimin nr. 3/1, datë 3.2.2026, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur: “*Kalimin për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 3, datë 3.11.2025, që i përket ankimit të magjstrates Ajshe Xhafa, ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 190, datë 2.4.2025. [...]*”.

15. Kolegji, në kuadër të gjykimit në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 3/2025, datë 3.11.2025, me ankuesë Ajshe Xhafa, kërkoi prapësimet/parashtrimet nga subjektet e interesuara. Subjektet e interesuara, KLGj-ja dhe ILD-ja, kanë depozituar në Kolegji prapësimet e tyre¹¹, respektivisht në datat 14.5.2026 dhe 18.5.2026, ndërsa në datën 15.5.2026, ka depozituar parashtrimet e saj edhe ankuesja, znj. Ajshe Xhafa¹².

I. Pretendimet e magjstrates Ajshe Xhafa në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

16. Magjistratja Ajshe Xhafa, nëpërmjet ankimit të depozituar në Kolegji ndaj vendimit të KLGj-së nr. 190, datë 2.4.2025, për shfuqizimin e vendimit “Për caktimin e masës disiplinore ‘Vërejtje publike’” dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegji në datën 15.5.2026, parashtron në mënyrë të përmblëdhur, si më poshtë.

17. Ankuesja pretendon se, gjatë procedimit disiplinor të saj, organet disiplinore kanë cenuar parimet mbi të cilat udhëhiqen, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor, prezumimi i pafajësisë, parimi i ligjshmërisë dhe dyshimi në favor të magjstratit. Sipas saj, para se të ndërhyhet në sferën profesionale dhe reputacionale, duhet të provohen me mjaftueshmëri fakte tipike dhe lidhja e tyre individuale me magjistratin, jo thjesht të konstatohet

një klimë e paqartë tensionesh ose një rrezik i përgjithshëm përsëritjeje.

18. Shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 101, paragrafi 1 dhe neni 102, paragrafi 2, shkronja “dh”, u referohen sjelljeve që cenojnë rregullat e solemnitetit, si dhe marrëdhënieve me palët apo magjistratët në një shkallë që prek besimin në drejtësi. Episodi i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje efektive me aktet, pas pamundësisë objektive për t'u pajisur me kopje të akteve gjatë orarit, pa deklarime publike dhe pa tejçim jashtë sallës. Vendimarrja unanime për gjykimin e shkurtuar dhe vendimin përfundimtar tregon se autoriteti kolegjal nuk u cenua në rezultat dhe se nuk u krijua ndikim i papranueshëm mbi paanësinë institucionale.

19. Neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, kërkon plotësimin e dy elementeve kumulative: i. ekzistencën e një sjelljeje që cenon rregullat e sjelljes; dhe ii. që kjo sjellje të jetë “e përsëritur” ose “e rëndë”, që në rastin konkret nuk plotësohen asnjë nga dy alternativat. Episodi, i pretenduar, i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, është një ngjarje e vetme, e zhvilluar në harkun kohor prej tetë minutash¹³ dhe nuk ka asnjë sjellje të ngjashme të provuar pas kësaj date. Shumësia e fjalëve të shqiptuara brenda së njëjtës seancë nuk përbën “përsëritje” në kuptim të shkronjës “dh”, pika 2, e nenit të sipërcituar.

20. Shkelja nuk është “e rëndë”, pasi edhe vetë KLGj-ja në parashtrime cilëson shkeljen si “shkelje e lehtë disiplinore”. Nëse shkelja është “e lehtë” dhe, gjithashtu, nuk është e përsëritur, atëherë nuk plotësohen asnjë nga dy alternativat e nenit 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016.

21. Aplikimi i nenit 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje efektive me aktet, pas pamundësisë objektive për t'u pajisur me kopje të akteve gjatë orarit, pa deklarime publike dhe pa tejçim jashtë sallës.

22. Elementi subjektiv nuk përmbushet në formën e dashjes direkte. Qëndrimi i magjstrates lidhet me nevojën reale për të siguruar njohje të plotë me fashikujt në një çështje voluminoze dhe me

¹¹ Sipas shkrësës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 15.5.2026, protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 18.5.2026 dhe shkrësës së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***}

prot., datë 12.5.2026, protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 13.5.2026.

¹² Protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 15.5.2026.

¹³ Sipas vendimit, ndërmjet orës 11:03 dhe 11:11.



kompleksitet të veçantë teknik, dhe jo me synimin për të ulur figurën e kolegeve.

23. Nuk provohet ardhja e pasojave të dëmshme në proces, pasi trupa gjyqësore vijoi me gjykimin dhe me një vendimmarrje unanime. Seanca gjyqësore ishte publike vetëm në aspektin formal, pasi prezentë ishin vetëm përfaqësuesi i akuzës dhe avokati mbrojtës. Pra, nuk mund të flitet për diskreditim të gjykatës dhe as për cenim real të besimit të publikut në kuptim të Parimeve të Bangalores.

24. Kërkesa për kopje të thjeshta ose të njësuara është mjet i arsyeshëm organizativ për të garantuar integritetin e dosjes dhe gjurmueshmërinë jashtë orarit zyrtar, në përputhje me nenin 3, pika 5 dhe nenin 4, të ligjit nr. 96/2016, si dhe me parimet e integritetit, respektit dhe transparencës së Kodit të Etikës Gjyqësore. Shtyrja e seancës gjyqësore dhe riadministrimi i akteve nga trupa gjyqësore konfirmojnë se shqetësimi procedural ishte legjitim dhe duhej adresuar me masa organizative, jo me sanksionim.

25. Masa disiplinore “Vërejtje publike” nuk qëndron, sepse bazohet kryesisht në një procesverbal të njëanshëm të sekretarit gjyqësor¹⁴, pa nënshkrimin e magistrates dhe pa garanci kundërshtimi. Për shkak të afateve të ngushta të seancave gjyqësore që lidheshin me masa sigurimi, kërkesa për fotokopjim të fashikujve brenda ditës, ishte e arsyeshme dhe e zakonshme, ndaj moszbatimi për fotokopjim të fashikujve, nuk mund t’i atribuohet si sjellje disiplinore gjykatësës që kërkonte akses të ligjshëm në akte. Ndërsa citimet audio të seancës gjyqësore janë përdorur të fragmentuara, ndaj, në këto rrethana, parimi i ligjshmërisë dhe i dyshimit në favor të magistratit gjatë procedurës disiplinore, kërkon mosvendosjen e një sanksioni publik.

26. Kërkesa për shtyrje, me qëllim njohjen me aktet e dosjes lidhëj drejtpërdrejt me detyrimin funksional për të vendosur me një kërkesë sensitive si gjykimi i shkurtuar, pa asnjë dashje direkte për denigrim. Imuniteti funksional mbron shprehjet gjatë ushtrimit të detyrës, përveç rasteve të

keqbesimit ose interesit vetjak, të paprovuara në dosje.

27. Përdorimi si rrethanë rënduese i një episodi nga një çështje tjetër tejkalon objektin e procedimit të njoftuar dhe cenon parimin e akuzës dhe së drejtës për mbrojtje. Pengesat objektive në qasjen ndaj fashikujve dhe vendimet për shtyrje e riadministrim, konfirmojnë se shqetësimi procedural ishte legjitim, jo denigrues.

28. Edhe nëse vlerësohet se gjuha e përdorur më datë 11.9.2024, meriton *vërejtje metodologjike*, proporcionaliteti nuk është arsytuar. Rrethanat lehtësuese të nenit 115/3 (herë e parë, ndikim i kufizuar të rrethi i ngushtë i palëve, bashkëpunim i plotë procedural, përvojë e kufizuar, mungesë dëmi material në proces dhe vendimmarrje unanime) imponojmë masa më të lehta sesa “Vërejtje publike” (neni 107, i ligjit nr. 96/2016), ndërsa mungesa e një analize të plotë të kriterëve cenon standardin e arsytimit të vendimit (neni 146, i ligjit nr. 96/2016).

29. Parimi i proporcionalitetit kërkon që masa të jetë e përshtatshme, e domosdoshme dhe e balancuar. Edhe sikur të pranohej se toni i komunikimit në atë seancë gjyqësore meriton *vërejtje metodologjike*, rrethanat lehtësuese janë të shumta sipas nenit 115, pika 3, përfshirë faktin se kemi shkelje për herë të parë, ndikim të kufizuar, bashkëpunim të plotë dhe përvojë të kufizuar kolegjiale gjatë vitit të parë në detyrë. Qëllimi edukativ dhe parandalues arrihet me mjete më pak stigmatizuese, si këshillimi etik ose vërejtja konfidenciale, jo me vërejtje publike që prek disproporcionalisht reputacionin profesional.

30. Vendimi i KLGj-së nuk plotëson standardin e vendimit të arsytuar në mënyrë të plotë, të individualizuar dhe të mbështetur në prova konkrete. Motivimi i vendimit duhet të jetë i individualizuar dhe i mbështetur në prova të verifikueshme. Formula të përgjithshme, si: marrëdhënie jo të normalizuara ose rrezik përsëritjeje, pa identifikuar ngjarje konkrete para datës 11 shtator 2024 dhe pa peshuar kundërproven mbi qasjen në dosje, nuk përmbushin kërkesat e nenit 146 dhe nenit 115, pika 2, e ligjit nr. 96/2016. Parimi i barazisë para ligjit kërkon, gjithashtu,

¹⁴ Procesverbali i nënshkruar vetëm nga sekretari gjyqësor, ka vlerë të kufizuar provuese për të provuar një refuzim me dashje (sipas këtij procesverbali, sekretari gjyqësor z. F. Th. ka ardhur në zyrën e magistrates për të dorëzuar fizikisht dosjen origjinale dhe se është refuzuar marrja fizike e dosjeve prej magistrates, duke i kërkuar që Faqe | 12098

të viben në dispozicion kopje të njësuara me origjinalin, si anëtare e trupit gjykues me të drejtën për t’u njohur me dosjen).



konsistencë sanksionesh në raste analoge, gjë që nuk del e argumentuar.

31. Masa e “Vërejtjes publike” rezulton jo e nevojshme dhe joproporcionale dhe e pajustificuar edhe në këndvështrimin e praktikës së GjEDNj-së¹⁵. Në përfundim, në mungesë të provës së mjaftueshme për elementet tipike të neneve 101, paragrafi 1 dhe 102, paragrafi 2, shkronja “dh”, në prani të rrethanave të qarta lehtësuese dhe pa pasoja reale në proces, kërkohet rrëzimi i saj dhe në subsidiaritet, vetëm nëse çmohet ndërhyrje edukative, zëvendësimi me një mjet më të butë dhe urdhërimi i masave organizative që standardizojnë qasjen në dosje në mënyrë që situata të ngjashme të mos përsëriten.

II. Prapësimet e KLGj-së, lidhur me pretendimet e magistrates Ajshe Xhafa

32. Sipas KLGj-së, pretendimi i ankueses se gjatë procedimit disiplinor të saj, organet disiplinore kane cenuar parimet mbi të cilat udhëhiqen, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor, prezumimi i pafajësisë, parimi i ligjshmërisë dhe dyshimi në favor të magistratit, nuk qëndron. KLGj-ja ka respektuar parimet e sanksionuara në nenin 100, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, si dhe ka marrë parasysh veçanërisht faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magistratit nga akuzat e pabaza dhe rëndësinë që ka informimi i publikut, në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

33. Nga shqyrtimi i procedimit disiplinor, rezultoi e provuar se magistratja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka kryer shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, duke shkelur rregullat e sjelljes me magistratët e tjerë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 11.9.2024, ku palë të pranishme kanë qenë përfaqësuesi i organit të akuzës dhe mbrojtësi i të pandehurit.

34. Magistratja Ajshe Xhafa, me sjelljen e saj, jo vetëm që ka vënë në dyshim integritetin e gjykatës, në lidhje me çështjen objekt gjykimi, por ka vënë në dyshim para palëve pjesëmarrëse dhe integritetin e gjykatës, në lidhje me një çështje tjetër, e cila nuk ka pasur lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjykimi i së

cilës kishte përfunduar kohë më parë, nga i njëjti trup gjykues.

35. Sjellja dhe retorika që magistratja ka përdorur në sallë të gjyqit, në seancën e datës 11.9.2024, në mënyrë të përsëritur, tregon se nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtare në vetëpërmbytje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet të karakterizojë një magistrat gjatë ushtrimit të detyrës, duke shkelur, pra duke mos respektuar vlerat themelore të përcaktuara në nenet 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016. Sjellja e saj në seancën gjyqësore publike nuk justifikohet edhe nëse e ka pasur të pamundur objektivisht njohjen me aktet e dosjes, apo nuk do t'i ishte vënë në dispozicion dosja për njohje.

36. Magistratja nuk ka treguar kujdesin e duhur për të ruajtur standardin e gjyqtare së përgjegjshme dhe profesionale, edhe pse ka pasur mundësitë të bënte një sjellje dinjitoze, për të mos cenuar integritetin e gjykatës, duke shkelur rëndë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që duhet të karakterizojnë një gjyqtare, duke përdorur më shumë se një herë, një retorikë të papërshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit, ndërsa ka qenë duke gjykuar në seancë gjyqësore me dyer të hapura, në prani të palëve, sjellje kjo e cila cenon integritetin dhe ul reputacionin e gjykatës. Qëndrimi i saj, shfaqur në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, përbën rrezik që të përçojë te palët përshtypjen se gjykata, dy gjyqtarët e tjerë, është duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët humbasin besimin në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

37. Magistratja Ajshe Xhafa ka konsumuar elementet e shkeljes disiplinore që ka të bëjë me sjelljen joetike të parashikuar në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016.

38. KLGj-ja, në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, ka marrë parasysh kriteret e parashikuara në nenin 115, pika 1, e ligjit nr. 96/2016.

39. Lidhur me llojin dhe rrethanat e shkeljes, rezulton se magistratja Ajshe Xhafa, subjekt procedimi disiplinor, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka shkelur rregullat e sjelljes me magistratët e tjerë pjesë e trupit gjykues, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 11.9.2024. Shkeljet e konstatuara, për shkak të rëndësisë së tyre, nuk

¹⁵ Wille kundër Libtebshtajnit (aplikimi nr. 28396/95, 28.10.2.1999, Dhoma e Madhe); Kudeshkina kundër Rusisë

(aplikimi nr. 29492/05, 26.2.2009); Baka kundër Hungarisë [Dhoma e Madhe] (aplikimi nr. 20261/12, 23.6.2016)



lidhen me veprimtarinë profesionale të një gjyqtari, por janë të natyrës që magjistrati duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

40. Duke analizuar shkallën e fajësisë dhe motivin, rezulton se shkelja disiplinore nga ana e magjistrates është kryer me dashje direkte, vërtetuar kjo edhe me deklaratimet e dhëna nga vetë ajo gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor, sikurse rezultoi edhe gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor në Këshill.

41. Sa u përket pasojave të shkeljes, sjellja e magjistratit dhe në veçanti e një gjyqtareje në sallën e gjyqit nuk është e rëndësishme vetëm në kontekstin profesional. Në respektim të parimeve të *Bangalores* për sjelljen në gjyqësor, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sjellje të caktuara të magjistratit, aq më tepër kur kjo sjellje cenon paanësinë e dy kolegeve të saj pjesë e trupit gjykues në prani të palëve, konsiderohet si cenim i parimit të besimit të palëve të pranishme te drejtësia, si dhe diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit, duke cenuar dhe integritetin e reputacionin e gjykatës.

42. Sipas KLGj-së, ekziston ende rreziku për të ndodhur ngjarje të cilat dëmtojnë imazhin e gjykatës, pasi gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor në Këshill, sipas deklaratimit të vetë magjistrates, marrëdhënia e saj me dy kolegët vazhdon të mos jetë e normalizuar, si edhe në seancën dëgjimore në Këshill, magjistratja ka deklaruar se vijonte të kishte marrëdhënie me disa kolegë dhe me disa të tjerë vetëm komunikim institucional.

43. KLGj-ja ka vendosur masën disiplinore sipas parashikimeve të nenit 115, pika 2, e ligjit nr. 96/2016, duke pasur parasysh kriteret: a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit; b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.

44. Në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj magjistrates dhe me konstatimin e përgjegjësisë së saj, nga ana e Këshillit është kryer jo në mënyrë abstrakte, por me referencë specifike ndaj të gjitha rrethanave në rastin konkret, një vlerësim i mirëfilltë i proporcionalitetit midis faktit të ngarkuar dhe sanksionit që duhet të jepet. Në këtë vlerësim janë marrë parasysh, në radhë të parë, rëndësia e fakteve në raport me përmasën e tyre objektive; në radhë të dytë, natyra dhe intensiteti i elementit psikologjik në sjelljen e kontestuar, së bashku me motivet që e kanë shtyrë; dhe, së fundmi,

personaliteti i magjistratit, veçanërisht në lidhje me aktivitetin e mëparshëm profesional dhe ndonjë precedent disiplinor.

45. Në caktimin e llojit të masës disiplinore në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara në nenin 115, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, janë mbajtur në konsideratë: i. ndaj magjistrates nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore; ii. shkelja e kryer ka pasur një ndikim në një rreth të kufizuar personash, pasi në sallën e gjyqit, në seancën e datës 11.9.2024, kanë qenë prezentë vetëm përfaqësuesi i organit të akuzës dhe mbrojtësi, nuk ka pasur subjekte të tjerë, si i pandehuri, viktimë apo trashëgimtarët e tij, si dhe pjesëmarrës nga publiku; iii. magjistratja ka kërkuar ndjesë dhe ka pranuar faktin që sjellja e saj nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se ajo nuk duhet të kishte atë sjellje në prezencë të palëve; iv. magjistratja është në vitin e parë të punës dhe se ajo ka mungesë eksperience në gjykimin e çështjeve me trup gjykues, pasi vetëm dy çështjet objekt hetimi disiplinor kanë qenë të vetmet që ajo ka gjykuar deri më datë 11.9.2024.

46. Ligji nr. 96/2016, në nenet 106 dhe 107 të tij, parashikon se masat disiplinore që Këshilli mund të japë kur shkelja është konsideruar si e lehtë janë: “Vërejtje konfidenciale”, e cila jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes (neni 106, pika 3) dhe “Vërejtje publike”, e cila jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike (neni 107, pika 3).

47. Sikurse ka rezultuar nga hetimi disiplinor i zhvilluar, shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore publike, në prani të palëve. Në këto kushte, duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes konkrete, në respektim të parimit të individualizimit dhe proporcionalitetit, Këshilli ka çmuar se masa disiplinore “Vërejtje publike” është masa më e përshtatshme, por edhe e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të një magjistrateje të sapoemëruar në detyrë, me qëllim parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen nga magjistratja subjekt procedimi disiplinor, por edhe nga magjistratë të tjerë.

III. Prapësimet e ILD-së, lidhur me pretendimet e magjistrates Ajshe Xhafa

48. Lidhur me pretendimin se nuk provohen me “mjaftueshmëri” faktet tipike dhe lidhja e tyre individuale me magjistratin:



48.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pretendimi i ngritur në ankim nga ankuesja, nuk qëndron, pasi, në kuadër të hetimit dhe procedimit disiplinor, janë kryer në mënyrë shteruese të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për të konkluduar mbi ekzistencën ose jo të shkeljes disiplinore, për të cilën është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa.

48.2 Kërkesa për procedimin disiplinor ndaj magjistrates dhe vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për pranimin e kësaj kërkesë, janë rezultat i vlerësimit në tërësi të fakteve dhe provave të administruara në procedimin disiplinor, marrja në pyetje e magjistratëve dhe punonjësve të tjerë të gjykatës që kanë dijeni për rrethanat e hetimit disiplinor, marrja në pyetje e vetë magjistrates Ajshe Xhafa, si dhe administrimi i provave shkruesore të pakundërshtueshme, sikurse janë procesverbalet e seancave gjyqësore.

48.3 Magjistratja nuk ka respektuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale, për më tepër gjatë ushtrimit të detyrës në seancë gjyqësore, gjatë gjykimit me dyer të hapura dhe në prezencë të palëve procedurale. Nga hetimi, ka rezultuar e provuar se gjyqtarja Ajshe Xhafa ka shkelur rregullat e sjelljes së gjyqtarit në sallën e gjyqit dhe ka vënë në dyshim jo vetëm integritetin dhe paanësinë e dy gjyqtareve të tjera, pjesë e trupës gjyqësore, por edhe të gjykatës në tërësi.

48.4 Magjistratja, Ajshe Xhafa, ka shkelur rëndë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që duhet të karakterizojnë një gjyqtare, duke përdorur më shumë se një herë gjatë një seance gjyqësore publike, në prezencë të palëve, një retorikë të papërshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit, duke cenuar integritetin dhe ulur reputacionin e gjykatës, dhe duke konsumuar në këtë mënyrë elementet e shkeljes disiplinore që ka të bëjë me sjelljen joetike të parashikuar nenin 101, pika 1 dhe në nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

49. *Lidhur me pretendimet se episodi i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje me aktet, pa deklarime publike dhe tejçim jashtë sallës së gjyqit, autoriteti kolegjial nuk u cenna në rezultat dhe nuk u krijua ndikim i papranueshëm mbi paanësinë institucionale, nuk provohet pasojë e dëmshme në proces apo jehonë përtej rrethit të ngushtë të të pranishmëve. Masa e vërejtjes publike bazohet në një*

procesverbal të njëanshëm të sekretarit, ndërkohë që citimet audio janë përdorur të fragmentuara.

49.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratja nuk ka treguar kujdesin e duhur për të ruajtur standardin e gjyqtarës së përgjegjshme dhe profesionale, edhe pse ka pasur mundësinë që të zgjidhte të bënte një sjellje dinjitoze për të mos cenuar integritetin e gjykatës.

49.2 Gjyqtarja nuk është mjaftuar vetëm me kërkesën për shtyrje me qëllim njohjen me aktet, por ajo ka vijuar retorikën me dy gjyqtaret e tjera në sallën e gjykimit. Mënyra e sjelljes dhe retorika e përdorur më shumë se një herë, tregon se ajo nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtarës me vetëpërmbytje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet të karakterizojë një magjistrat gjatë ushtrimit të detyrës.

49.3 Edhe në pamundësi objektive për njohjen me aktet, dhe në rastin më të keq, nëse nuk do t'i ishte vënë në dispozicion dosja, magjistratja, gjyqtare Ajshe Xhafa, duhej të shmangte së shprehuri në sallën e gjyqit opinionet e saj personale, në lidhje me veprimtarinë e dy gjyqtarëve, pasi në këtë mënyrë ka rrezikuar të përçojë te palët përshtypjen se gjykata është duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët të mos kenë besim që do të zhvillohet një proces i rregullt ligjor.

50. *Lidhur me pretendimin se përdorimi si një rrethanë rënduese i një episodi nga një çështje tjetër, tejkalon objektin e procedimit të njoftuar dhe cenon parimin e akuzës dhe së drejtës për mbrojtje:*

50.1 Në zbatim të nenit 123, pika 3, shkronja “dh”, nenit 129, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, magjistrates i është njoftuar vendimi i ILD-së nr. 2448/2 prot., datë 15.10.2024, “Për fillimin e procedimit disiplinor”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 101, pika 1 dhe 102, pika 2, shkronja “dh” e po të njëjtit ligj.

50.2 Magjistratja ka marrë dijeni për hetimin disiplinor, të drejtat dhe detyrimet e subjektit të hetimit dhe, referuar përmbytjes së këtij vendimi, kuptohet se objekti i hetimit ka qenë edhe veprimtaria e magjistrates në drejtim të administrimit të dy dosjeve gjyqësore, si dhe ka dhënë shpjegime në lidhje me të dyja çështjet, si gjatë fazës së hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD-ja, dhe gjatë procesit disiplinor të zhvilluar pranë KLGj-së.



51. Lidhur me pretendimin se edhe nëse vlerësohet se gjyba e përdorur më datë 11.9.2024, meriton një vërejtje metodologjike, proporcionaliteti nuk është arsyetuar:

51.1 Referuar parashikimeve të nenit 110, të ligjit nr. 96/2016, parimi i proporcionalitetit është një prej parimeve që përshton fazën e hetimit dhe procedimit disiplinor. Parashikimi i tij në mënyrë specifike i shërben garantimit të respektimit të procesit të rregullt ligjor, në funksion të caktimit ndaj magjistratit të një mase disiplinore që është në përpjesëtim me nivelin e shkeljes disiplinore të kryer dhe pasojave të ardhura.

51.2 Sipas ILD-së, pretendimi i ankueses se rrethanat lehtësuese imponojnë masa më të lehta sesa “Vërejtje publike”, si dhe këshillimi etik ose vërejtje konfidenciale, jo me vërejtje publike, nuk qëndron.

51.3 Ndryshe nga sa pretendon ankuesja, në caktimin e llojit të masës disiplinore, janë marrë në konsideratë, si dhe janë analizuar kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes, parimi i proporcionalitetit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara në nenin 115, të ligjit nr. 96/2016.

51.3.1 Në rastin konkret, janë vlerësuar si rrethana lehtësuese: i. kryerja e shkeljes për herë të parë, duke qenë se nuk ka masë të mëparshme disiplinore; ii. ka pranuar se sjellja e saj në seancën gjyqësore publike të datës 11.9.2024, nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se nuk duhet ta kishte bërë atë sjellje në prani të palëve procedurale; iii. fakti që ka qenë magjistrate e emëruar më datë 12.10.2023 dhe nuk ka pasur eksperiencë profesionale.

51.3.2 Ndërsa, si rrethana rënduese, janë vlerësuar: i. shkelja është kryer në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve procedurale; ii. sjellja ka qenë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë seancës; iii. marrëdhënia e magjistrates me dy koleget e saj, anëtare të së njëjtës trupë gjykuese, nuk ka qenë e stabilizuar.

51.4 Në analizë të kriterëve që lidhen me llojin dhe rrethanat e shkeljes, pasojat e shkeljes, shkallën e fajësisë dhe motiveve, rezulton se masa disiplinore më e përshtatshme, por edhe e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të një magjistrateje të sapoemëruar në detyrë, por edhe qëllimin parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen nga vetë magjistratja, por edhe nga magjistratët e tjerë, është pikërisht masa disiplinore “Vërejtje publike”.

52. Lidhur me pretendimin se rrethanat lehtësuese imponojnë një masë më të lehtë disiplinore, sikurse mund të jetë “Vërejtje konfidenciale”:

52.1 Në referim të nenit 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes”. Në rastin konkret, nga hetimi ka rezultuar se shkelja ka ndodhur gjatë një seance gjyqësore publike, në prezencë të palëve procedurale.

53. Hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor i kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor janë realizuar në përputhje të plotë me parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor. Gjatë procesit disiplinor janë respektuar në tërësi parimet që udhëheqin këtë proces, të sanksionuara nga neni 100, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

54. Magjistratja Ajshe Xhafa, me veprimet/mosveprimet e saj, ka kryer shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Për legjitimitimin e ankuesit

55. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9-vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon: “Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”.

56. Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3, shkronja “b”, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelit bazën ligjore mbi të cilën do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues, që lidhet me Juridiksionin Disiplinor,



konkretisht: Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

57. Çështja e legjitimitetit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

58. Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

59. Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimitimin e ankuesit, Kolegji vlerëson se ankuesja Ajshe Xhafa legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i KLGj-së, të cilin e ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj dhe, për pasojë, ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

60. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P” e Kushtetutës, konstatohet se neni 100, pika 1, e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 179, pika 7 e

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelit. Pra, ankuesja nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

60.1 Ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i KLGj-së që ankimohet, është i datës 2.4.2025¹⁶, ndërsa ankimi i magjstrates Ajshe Xhafa është protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit më datë 3.11.2025 dhe është regjistruar në të njëjtën datë, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577/2000.

60.2 Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit

61. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të magjstrates Ajshe Xhafa, kundër vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të KLGj-së, Kolegji, pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikullin e çështjes së juridiksionit disiplinor nr. 3/2025, datë 3.11.2025, konstaton dhe vlerëson si vijon.

62. Kolegji vlerëson se, në kuadër të hetimit dhe procedimit disiplinor ndaj magjstrates, ILD-ja dhe KLGj-ja kanë kryer të gjitha veprimet hetimore për konkludimin mbi ekzistencën ose jo të shkeljes disiplinore ndaj magjstrates, si dhe procedurat për caktimin e masës disiplinore, në përputhje me parimet e procedimit disiplinor të parashikuara në nenin 100, pika 1, e ligjit nr. 96/2016. Parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të hetimit disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe të procedimit disiplinor, i cili shqyrtohet dhe vendoset nga Këshilli, si një organ vendimmarrës kolektiv.

63. Nga aktet që dokumentojnë marrjen e vendimit të KLGj-së, konstatohet se magjistratja Ajshe Xhafa është vënë në dijeni se ajo do të jetë pjesë e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale me nr. {***}, që në datën 29.7.2024, datë në të cilën është zhvilluar shorti. Kolegji vëren se, nga kjo datë

¹⁶ Njoftuar magjstrates, me shkresën e KLGj-së nr. {***} prot., datë 1.7.2025, marrë dijeni më datë 4.7.2025, sipas vulës së Zyrës



deri në datën e planifikuar për gjykimin e kësaj çështjeje penale, 11.9.2024, magjistratja ka pasur kohën e nevojshme për t'u njohur me aktet e dosjes penale dhe marrjen e të gjitha masave jo vetëm për përgatitjen e saj për gjykimin e çështjes penale, por edhe për shmangien e shtyrjes së seancës gjyqësore, qoftë edhe në eventualitetin e pamundësisë për t'u njohur me aktet e dosjes kur ato iu vunë në dispozicion nga sekretari gjyqësor.

64. Deklarimet në seancën gjyqësore publike, replika me kryesuesen e trupit gjykues, si dhe relatimet në seancë, lidhur me pamundësinë e saj për t'u njohur me aktet e dosjes penale në gjykim, si dhe të një tjetër çështjeje penale, sipas përmbajtjes së procesverbalit gjyqësor të zhvillimit të seancës publike të datës 11.9.2024, të pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit, bien në kundërshtim me rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale të magistrates dhe, aq më tepër, kur është duke ushtruar detyrën e gjyqtarit në një seancë gjyqësore, gjatë gjykimin me dyer të hapura, në prezencë të palëve.

65. Pretendimi i ankueses, se nuk i është krijuar mundësia të njihej me dosjen para seancës gjyqësore publike, duke kundërshtuar në këtë mënyrë edhe procesverbalin e mbajtur nga sekretari për dokumentimin e vënies në dispozicion të fashikujve të çështjes penale, çmohet pa efekt në analizimin nga Kolegji të sjelljes së saj, e cila vlerësohet e papranueshme dhe me pasojë cenimin e integritetit profesional të magistrates dhe, mbi të gjitha, të vetë gjykatës. Kjo sjellje dhe retorikë e saj në një seancë gjyqësore publike vlerësohet si e tillë, pavarësisht faktit nëse magjistratja ishte objektivisht e justifikuar në mosnjohjen e dosjes penale për gjykim.

66. Konstatimi nga Kolegji i sjelljes dhe retorikës së përdorur nga ankuesja në sallën e gjyqit, gjatë një gjykimi në seancë publike dhe në mënyrë të përsëritur, tregon se ajo, përveçse nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtare me vetëpërmbajtje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet ta karakterizojë një magjistrat gjatë ushtrimit të detyrës, ka cenuar edhe solemnitetin e procesit gjyqësor, sjellje kjo në cenim

të vlerave themelore dhe standardeve të etikës dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara në nenet 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2026 dhe aktet ndërkombëtare lidhur me to.

67. Rezultoi, gjithashtu, e provuar se gjyqtarja Ajshe Xhafa ka shkelur rregullat e sjelljes së gjyqtarit në sallë të gjyqit, duke vënë në dyshim integritetin dhe paanësinë e dy gjyqtareve të tjera, pjesë e trupit gjykues. Sipas Kodit të Etikës Gjyqësore¹⁷: *Gjyqtari duhet të ruajë dhe të zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia të ruhen*¹⁸. Qëndrimi i shfaqur në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, nga magjistratja, përbën rrezik që të përçojë te palët përshtypjen se gjykata, dy gjyqtaret e tjera, janë duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët të humbasin besimin në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor¹⁹.

68. Parimet e Bangalores të Sjelljes së Gjyqësorit – Kompetenca dhe Kujdesi, përcaktojnë se: *“Veprimtaria gjyqësore ka përparësi kundrejt çdo veprimtarie tjetër. Një gjyqtar do t'i përkushtohet veprimtarisë së tij gjyqësore, e cila përfshin jo vetëm performancën e funksioneve gjyqësore dhe përgjegjësinë në marrjen e vendimeve, por edhe funksione të tjera me rëndësi për funksionet gjyqësore ose për veprimtarinë e gjykatës. Një gjyqtar do të kryejë hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe zhvilluar aftësitë profesionale, njohuritë dhe cilësitë njerëzore të nevojshme për zbatimin e detyrave, duke përfshirë nga trajnimet dhe lehtësira të tjera që do t'i ofrohen, nën kontrollin gjyqësor. Një gjyqtar do jetë i informuar mbi zhvillimet e rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë komventat ndërkombëtare dhe instrumente të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut. Një gjyqtar do t'i kryejë të gjitha detyrat e tij, duke përfshirë vendimet, eficientë, drejtësinë dhe respektimin e afateve. Një gjyqtar do të mbajë rend dhe qetësi në sallën e gjyqit dhe do të jetë i duruar, dinjitoz në marrëdhëniet me palët, të miturit, dëshmitarët, avokatët dhe të tjerët me të cilët ai ndërvepron për shkak të funksionit të tij. Gjyqtari do të kërkojë sjellje të ngjashme edhe nga ana e përfaqësuesve ligjor, personeli i gjykatës dhe personat e tjerë nën ndikimin, autoritetin dhe kontrollin e gjyqtarit. Një gjyqtar nuk do të përfshihet në sjellje*

¹⁷ Miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 171, datë 22.4.2021, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 29.4.2021.

¹⁸ Kodi i Etikës Gjyqësore, “Dispozita të përgjithshme”, pika 3 e tij.

¹⁹ Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutit dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi Faqe | 12104

i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimëve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet”.



të papajftueshme me përgjegjësinë dhe kujdesin në kryerjen e funksioneve gjyqësore.”.

69. Në analizë të situatës faktike, si më sipër konstatuar dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa pretendon ankuesja/magjistratja, elementet e shkeljes disiplinore të parashikuara në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, rezultuan të provuara gjatë procedimit disiplinor.

70. Në shqyrtim të pretendimit të ankuses mbi cenimin e procesit të rregullt ligjor, standardit të arsytimit të vendimit të KLGj-së, si dhe të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” të caktuar ndaj saj, Kolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, konkluzion ky i mbështetur në një analizë të hollësishme të procedurave të ndjekura nga ILD-ja gjatë hetimit disiplinor dhe nga KLGj-ja gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, deri në caktimin e masës disiplinore ndaj ankuses, gjatë të cilit nuk u konstatuan shkelje me pasojë cenimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor.

71. Përkundër nga sa pretendon ankuesja, Kolegji vlerëson se KLGj-ja, në përcaktimin e rëndësisë së shkeljes dhe caktimit të masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj saj, rezulton të ketë mbajtur në konsideratë dhe të ketë analizuar hollësisht kriteret e nenit 115, të ligjit nr. 96/2016.

72. Në vlerësim të rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, rezultoi se KLGj-ja ka marrë parasysh: llojin dhe rrethanat e shkeljes; shkallën e fajësisë dhe motivin; pasojat e shkeljes; të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratëve; masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; çdo rrethanë të lidhur me gjendjen shëndetësore të magjistratit; rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; çdo çështje tjetër që Këshilli i konsideron të rëndësishme.

73. Në analizë të kriterëve të parashikuara në nenin 115, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, konkretisht atë lidhur me natyrën dhe rrethanat e shkeljes, rezulton se ankuesja/magjistratja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka shkelur normat e sjelljes ndaj magjistratëve të tjerë pjesëmarrës në trupin gjykues

në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, veprime të cilat janë kryer gjatë një seance gjyqësore publike, në prani të përfaqësuesit të organit të akuzës dhe mbrojtësit të të pandehurit dhe, për shkak të rëndësisë së tyre, këto shkelje nuk lidhen me aspektet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, por përbëjnë sjellje që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore.

74. Sa i përket kriterit që ka të bëjë me *shkallën e fajësisë dhe motivin*, ankuesja/magjistratja e ka kryer shkeljen disiplinore me dashje të drejtpërdrejtë, pasi kjo provohet nga deklaratimet e saj gjatë hetimit disiplinor, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të procedimit në KLGj dhe nga shpjegimet e palëve, nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura prej tyre, në kuadër të shqyrtimit të ankimit të ankuses Ajshe Xhafa.

74.1 Lidhur me analizën e kriterit *mbi pasojat e shkeljes*, vlerësohet se sjellja e ankuses Ajshe Xhafa, veçanërisht e një gjyqtareje në sallën e gjyqit, ka rëndësi jo vetëm në planin profesional të gjyqtarës, në integritetin e procesit gjyqësor dhe në drejtën të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë. Në përputhje me Parimet e *Bangalores* për sjelljen gjyqësore, cenimi i normave etike, qoftë në marrëdhëniet e punës apo jashtë tyre, mund të ndikojë negativisht në besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë. Në rastin konkret, sjellja e saj ka vënë në dyshim paanësinë e dy kolegeve gjyqtareve para palëve ndërgjyqëse – kjo konsiderohet si cenim i parimit të besimit të palëve të pranishme të drejtësisë, si dhe diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit, duke cenuar integritetin dhe reputacionin e gjykatës.

74.2 Në kuadër të kriterit *që lidhet me të dhënat profesionale, disiplinore dhe penale të magjistratit*, rezulton se ankuesja është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 552, datë 12.10.2023, të KLGj-së dhe nuk ka ende vlerësime etiko-profesionale, si dhe ndaj saj nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë disiplinore.

74.3 Në analizën e kriterit për *masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore*, rezulton, nga aktet e dosjes, si dhe shpjegimet e ankuses, se marrëdhënia e saj me dy gjyqtaret e tjera nuk është normalizuar ende, gjë që mund të krijojë premisa për sjellje të tjera të papërshtatshme në të ardhmen dhe, rrjedhimisht, paraqet rrezik real për dëmtimin e imazhit të gjykatës.

74.4 Në lidhje me kriterin *e rrethanave të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit*, konstatohet se edhe



gjatë hetimit disiplinor nga ILD-ja, ashtu edhe gjatë shqyrtimit në KLGj, nuk rezultuan të dhëna apo rrethana të asaj natyre që të kishin ndikim në vlerësimin e çështjes.

74.5 Në analizën e kriterit në lidhje *me sjelljen e magistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas nisjes së hetimit*, vlerësohet se ankuesja/magjistratja ka treguar bashkëpunim, pasi: i. ka paraqitur shpjegimet e saj pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është paraqitur për t'u pyetur kur është kërkuar dhe ka pranuar faktet, duke shpjeguar arsyet e sjelljes së saj; ii. ka kërkuar ndjesë dhe ka pranuar se veprimi i saj nuk ishte në përputhje me normat etike dhe se nuk duhej të ishte kryer në prani të palëve; iii. në perceptimin e saj, dy gjyqtaret kanë mbajtur qëndrim tendencioz ndaj saj që nga fillimi i ushtrimit të detyrës në gjykatë.

74.6 Në kuadër të kriterit që lidhet *me sjelljen e magistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin ndaj tij*, rezultoi se ajo ka bashkëpunuar me ILD-në dhe KLGj-në, duke dorëzuar parashtrimet brenda afateve ligjore²⁰ dhe duke marrë pjesë në seancën dëgjimore.

74.7 Në analizë të kriterit *mbi rrethanat apo çështje të tjera që Këshilli i konsideron të rëndësishme për çështjen*, rezultoi se gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në KLGj, e pyetur se si do të vepronte në të ardhmen nëse do të kishte këto shqetësime të ngjashme, ankuesja/magjistratja ka deklaruar se vijonte të kishte marrëdhënie me disa kolegë, ndërsa me disa të tjerë komunikim vetëm institucional.

75. Kolegji konstaton se KLGj-ja, në vendosjen e masës disiplinore, ka marrë në analizë edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, në përputhje me parimin e proporcionalitetit për efekt të caktimit të masës disiplinore të përshtatshme, të domosdoshme dhe të balancuar në raport me shkeljen e konstatuar.

76. Në vijim të analizës si më sipër, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, janë vlerësuar si rrethana lehtësuese: i. kryerja e shkeljes për herë të parë, duke qenë se nuk ka masë të mëparshme disiplinore; ii. ka pranuar se sjellja e saj në seancën gjyqësore publike të datës 11.9.2024, nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se nuk duhet ta kishte bërë

atë sjellje në prani të palëve procedurale; iii. fakti që ka qenë magjistrate e emëruar më datë 12.10.2023 dhe nuk ka pasur eksperiencë profesionale.

77. Ndërsa, si rrethana rënduese, janë vlerësuar: i. shkelja është kryer në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve procedurale; ii. sjellja ka qenë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë seancës; iii. marrëdhënia e magistrates me dy koleget e saj, anëtare të së njëjtës trupë gjykuese, nuk ka qenë e stabilizuar.

78. Ligji për Statusin, në nenet 106, 107, parashikon se masat disiplinore që Këshilli mund të japë, kur shkelja disiplinore është konsideruar si e lehtë, janë “Vërejtje konfidenciale” dhe “Vërejtje publike”.

79. Në nenin 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes”. Ndërsa, neni 107, pika 3 e po këtij ligji parashikon se: “Vërejtje publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike”.

80. Rezultoi e provuar nga aktet se shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 11.9.2024, të një çështjeje penale, në prani të palëve, prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit. Në këto kushte, duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes konkrete, në respektim të parimit të proporcionalitetit, Kolegji vlerëson se masa disiplinore “Vërejtje publike” është masa më e përshtatshme, por edhe e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të ankueses/magjistrates Ajshe Xhafa, të sapoemëruar në detyrë, me qëllimin parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen prej saj, por edhe nga magjistratë të tjerë.

81. Pretendimi i ankueses se rrethanat lehtësuese imponojnë një masë më të lehtë disiplinore “Vërejtje konfidenciale”, për shkak se publiku nuk është i përfshirë, se në seancë gjyqësore ishin prezentë vetëm prokurori dhe mbrojtësi i të pandehurit, ndaj ndikimi është i kufizuar vetëm në dy persona, në rastin konkret nuk qëndron, pasi nga hetimi disiplinor dhe shpjegimet e parashtruara në Kolegji nga vetë ankuesja, ka rezultuar se shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë një seance gjyqësore publike dhe

²⁰ Dorëzuar parashtrime nga ankuesja Ajshe Xhafa në datën 12.11.2024, pranë ILD-së dhe në datën 17.3.2025, pranë KLGj-së.



në prezencë të palëve procedurale. Bazuar në nenin 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, “Vërejtja konfidenciale” jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes.

82. Në këto kushte, Kolegji i Posaçëm i Apelit, arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të magistrates, të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe vlerësuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në procedimin disiplinor ndaj saj, janë të tilla që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e vërejtjes publike, e dhënë ndaj magistrates nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

83. Për sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të ankueses, çmon se vendimi nr. 190, datë 2.4.2025, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj, dhe kërkesa e magistrates Ajshe Xhafa nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magistrates Ajshe Xhafa kundër vendimit 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore ‘Vërejtja publike’ ndaj magistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.5.2026.

Shpallur më 16.6.2026.

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtarë: Rezarta Schuetz, Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Albana Shtylla



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 131][Datë: 23.06.2026 12:42:05
+02:00][2c2a868e-9f7b-4e7b-ad7a-599933337d25

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)